




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijena - Office of the Prime Minister

Raporti

i zbatimit të Programit për Parandalimin
dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative **2022-2027**
dhe Planit të veprimit **2022-2024**



Periudha e
raportimit:
2022-2023

Janar 2024

	Përmbledhje	03
1.	Qasja strategjike	06
2.	Qëndrueshmëria	08
2.1.	Mekanizmat	08
2.2.	Mjetet	09
2.3.	Ekspertiza	11
2.4.	Trajnimet	11
3.	Parandalimi	18
3.1.	Koncept dokumentet	19
3.2.	Legjislacioni	20
4.	Zvogëlimi	22
4.1.	Masat dhe aktivitetet për thjeshtim dhe digjitalizim në nivel qendror	22
4.2.	Masat dhe aktivitetet për thjeshtim të shërbimeve në nivel lokal	28
4.3.	Matja e zvogëlimit të barrës administrative në nivel qendror dhe lokal	29
5.	Bashkëpunimi	31
	SHTOJCA 1: Lista e shërbimeve të thjeshtuara në MINT, MMPHI dhe MBPZHR	34
	SHTOJCA 2: Lista e shërbimeve të thjeshtuara në MPB	36
	SHTOJCA 3: Lista e shërbimeve të thjeshtuara në Komunën e Prizrenit	38
	SHTOJCA 4: Lista e shërbimeve të thjeshtuara në Komunën e Ferizajt	41
	SHTOJCA 5: Lista e shërbimeve të thjeshtuara në Komunën e Pejës	46

Përmbledhje

Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 dhe Plani i Veprimit 2022-2024 (tash e tutje Programi), është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (tash e tutje Qeveria) me datën 14 shtator 2022.¹ Që nga miratimi i Programit, nën mbikëqyrjen e Zëvendëskryeministrit të Parë dhe nën udhëheqjen dhe koordinimin e Zyrës për Planifikim Strategjik (tash e tutje ZPS) të Zyrës së Kryeministrit (tash e tutje ZKM), të gjitha objektivat strategjike dhe specifike sipas planit të veprimit për zbatimin e Programit kanë shënuar një progres të mirë, i theksuar edhe nga raportet ndërkombëtare.²

Duke marrë për bazë që Programi është zhvilluar në atë formë që të jetë një dokument fleksibil që ndryshon për procesin dhe nga procesi, një numër i aktiviteteve, ndonëse nuk janë të theksuara në mënyrë specifike në Planin e Veprimit (tash e tutje PV), zbatimi i tyre është mbështetur në kuadër të Programit, të cilat ndërlidhen me aktivitetet të theksuara në Plan dhe me qasjen e Programit. Po ashtu, arritja e rezultateve të shprehura në Raport, është bërë fillimisht nga mbështetja e madhe politike dhe prioritizimi i procesit nga Zëvendëskryeministri i Parë dhe Kabineti i tij, mbështetja, bashkëpunimi dhe komunikimi i mirë nga Ministritë të linjës dhe agjencive relevante, bashkëpunimi dhe avokimi i organizatave të shoqërisë civile³ dhe odave të biznesit⁴, si dhe me mbështetjen e madhe të partnerëve zhvillimorë.

Të arriturat kryesore për periudhën raportuese në kuadër të zbatimit të Programit, fokusohen në udhëheqje, koordinim dhe zbatim, parandalim dhe zvogëlim të barrës administrative, Organizimi i punës sipas këtyre aspekteve të cilat janë të pandashme dhe njëkohësisht krijojnë sinergji, ka ndikuar në ngritjen e vëmendjes së zyrtarëve publikë, shoqërisë civile dhe odave të biznesit mbi rëndësinë dhe kujdesin që duhet t'i jepet barrës administrative për qytetarë dhe biznese. Organizimi i punës sipas këtyre aspekteve të cilat janë të pandashme dhe njëkohësisht krijojnë sinergji, ka ndikuar në ngritjen e vëmendjes së zyrtarëve publikë, shoqërisë civile dhe odave të biznesit mbi rëndësinë dhe kujdesin që duhet t'i jepet barrës administrative për qytetarë dhe biznese. si dhe bashkëpunim për zbatim të Programit, të përmbledhura si më poshtë:

“UDHËHEQJA, KOORDINIMI DHE ZBATIMI”

- Është definuar hierarkia e përgjegjësisë për zbatimin e programit dhe planit të veprimit dhe deri tani janë organizuar dy takime të Komisionit për Planifikim Strategjik (tash e tutje KPS) të kryesuar nga Kryeministri me qëllim shtyrjen për-

¹Vendimi 27/96 Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 14.09.2022, [linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2022/09/Vendimet-e-Mbledhjes-se-96-te-te-Qeverise.pdf>]. Disa prej aktiviteteve të paraqitura në raport janë filluar nga ZPS para miratimit të Programit, me qasjen e njëjtë. Prandaj, edhe këto aktivitete janë pjesë e Raportit.

² Raporti për Vendi 2023 i Komisionit Evropian, [linku: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/systemfiles/2023-11/SËD_2023_692%20Kosvo%20report_0.pdf].

³ Respektivisht Demokraci Plus (D+), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Open Data Kosovo (ODK) dhe Instituti GAP (GAP).

⁴ Si për shembull me Oden Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK).

para të zbatimit të Programit. Zëvendës Kryeministri i parë ka mbështetur procesin në baza të rregullta dhe është përgjegjësi politik i këtij procesi. Në aspektin operativ, ZPS është caktuar si Sekretariat i KPS-së kurse Qeveria me vendim ka emëruar Koordinatorin e procesit të Barrës Administrative.


- Janë emëruar 52 zyrtarë përgjegjës për barrën administrative, në nivel qendror janë 20 persona të emëruar me vendime të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Drejtorëve të Agjencive Ekzekutive relevante, dhe në nivel lokal janë 32 persona të emëruar me vendim të Kryetarëve të Komunave.
- Janë ndërmarrë 10 aktivitete në funksion të zhvillimit të metodologjive apo mjeteve tjera në funksion të zbatimit të programit, si analiza, udhëzues dhe katalog. Ka filluar analizimi i institucioneve të pavarura që përfshijnë 110 lejime dhe ka filluar analizimi për digjitalizimin e 150 lejimeve të tjera. Nga këto 10 aktivitete, gjashtë (6) janë kryer dhe katër (4) janë në proces.
- Janë ndërmarrë gjithsej 85 aktivitete për zbatimin e programit dhe planit të veprimit, **62** prej të cilave të përfunduara dhe **23** në proces që të përfundohen në vitin 2024.

PARANDALIMI I BARRËS ADMINISTRATIVE

- Në funksion të parandalimit të barrës administrative janë ndërmarrë gjashtë (6) aktivitete në përgjithësi, tri (3) prej të cilave janë kryer dhe tri (3) tjera në proces. Në këtë kuadër të aktiviteteve të kryera, janë kontrolluar/shqyrtuar 77 draft dokumente të politikave në fazën

e hartimit, me qëllim parandalimin e barrës administrative (20 koncept dokumente, 14 projektligje dhe 43 projekt akte nënligjore).

- Është përgatitur materiali i trajnimit, modulet që lidhen ngushtë me barrën administrative, janë zhvilluar ushtrimet sipas moduleve, është përgatitur testi për matjen e ndikimit të trajnimeve dhe janë trajnuar 65 zyrtarë të nivelit qendror dhe lokal. Në funksion të ngritjes së vetëdijes së zyrtarëve publikë për barrën administrative dhe adresimin e saj, nga gjashtë (6) aktivitete të planifikuara, pesë (5) janë kryer kurse një (1) është në proces.
- Nga 65 zyrtarë publikë të trajnuar deri tani, 27 janë të nivelit qendror kurse 38 të nivelit lokal. Sa i përket pjesëmarrjes gjinore, është vërejtur pjesëmarrje më e ulët e grave (37%) në krahasim me burrat (63%). Në këtë përqindje të vogël ka ndikuar pjesëmarrja e ulët e grave nga niveli lokal me vetëm 18%.
- Ndonëse deri tani mund të ceket që ka pasur një pjesëmarrje të vogël në përgjithësi të zyrtarëve publikë, rezultati i testit vlerësues tek 65 zyrtarët vlerësohet i lartë pasi numri i përgjigjeve të sakta në testin në ditën e parë të trajnimit dhe testit në ditën e fundit të trajnimit, ka një ngritje prej 20%, si total, për të dy gjinitë.⁵



⁵ Aktivitetet e hijezuara me ngjyrë të gjelbër në tabela janë aktivitete të përfunduara, ndërsa aktivitetet me ngjyrë të kaltër janë aktivitete në proces, që do të vazhdojnë në vitin 2024

- Janë thjeshtuar **152** shërbime në nivel qendror dhe lokal kurse janë eliminuar **64** shërbime tjera në nivel lokal, në **tri** komuna. Nga ky proces, në bazë vjetore janë kursyer mbi 2 milion euro sipas matjeve nëpërmjet modelit të kostimit standard.
- Mbi 30 shërbime kanë filluar të digjitalizohen në tërësi (pala aplikon, kryen veprimet shtesë me institucionin dhe e merr shërbimin online). Shërbimet që janë në përfundim të digjitalizimit janë: 1) shërbimet e profesioneve të lira që ofrohen nga Ministria e Drejtësisë (tash e tutje MD), 2) shërbimet gjeodezike që ofrohen nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (tash e tutje AKK),; 3) shërbimet që ndërlidhen me auto shkolla që ofrohen nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tash e tutje MMPHI); ndërsa shërbimet që janë në fillim të digjitalizimit janë 4) shërbimet për njohjen e diplomave që ofrohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (tash e tutje MASHTI) ; 5) shërbimet për grante dhe subvencione në Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (tash e tutje MKRS). Mbi 50 shërbime tjera janë të planifikuara të digjitalizohen me të njëjtën qasje në vitin 2024.
- Në funksion të zvogëlimit të barrës administrative janë ndërmarrë **46** aktivitete në nivel qendror dhe lokal. Prej tyre, 39 aktivitete janë ndërmarrë në nivel qendror, 12 prej të cilave janë në proces, kurse nga shtatë (7) aktivitete të ndërmarra në nivel lokal, janë përfunduar të gjitha.

- Në nivel qendror në katër ministri janë thjeshtuar 49 shërbime dhe nga thjeshtimi janë kursyer rreth 1.6 milion euro. Në MINT janë thjeshtuar 32 shërbime, në MPB 14 shërbime, në MMPHI 2 shërbime dhe në MBPZHR është thjeshtuar një (1) shërbim.
- Në nivel lokal në **3** komuna janë thjeshtuar **103** shërbime, janë eliminuar **64** dhe janë arritur kursime si rezultat i thjeshtimit dhe eliminimit në vlerë prej rreth **628,688** EUR. Komunitat e përfshira në thjeshtim dhe eliminim janë Prizreni (37 shërbime të thjeshtuara dhe 25 të eliminuara), Ferizaj (50 shërbime të thjeshtuara dhe 26 të eliminuara) dhe **Peja** (16 shërbime të thjeshtuara dhe **13** të eliminuara). Në vitin 2024 pritet të thjeshtohen edhe rreth 100 shërbime tjera nëpër komunitat tjera.

BASHKËPUNIMI PËR ZBATIM



- Gjatë periudhës raportuese, është arritur bashkëpunim i ngushtë me akterë relevantë si partnerë zhvillimorë, shoqërinë civile, odat ekonomike dhe të biznesit dhe organizata ndërkombëtare. Nga gjithsej 13 aktivitete të ndërmarra në funksion të bashkëpunimit, vetëm 3 prej tyre janë në proces kurse 10 të tjera janë përfunduar ashtu siç janë paraparë me planin e veprimit.

"Arritjet e theksuara më lartë dhe zbatimi i Programit do të ishte i mangët pa mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe Gjermanisë, nëpërmjet projektit të bashkë-financuar për zvogëlimin e barrës administrative, si pjesë e modulit "Mbështetje e Reformave për Integrim Evropian në Kosovë", i zbatuar nga GIZ, si dhe pa mbështetjen e Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) të Qeverisë Zvicerane, nëpërmjet projektit "Përsheptimi i klimës së investimeve", i zbatuar nga Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC)."

- Palët e interesuara, mund të kërkojnë të gjitha dëshmitë për të arriturat e paraqitura në këtë Raport, në Zyrën për Planifikim Strategjik të Zyrës së Kryeministrit.

1. QASJE STRATEGJIKE

Zbatimi i Programit për vitin 2022-2023 është shoqëruar me aspekte kryesore, të cilat janë thelbësore për arritjen e rezultateve në zbatim. Të gjitha aktivitetet e zbatuara lidhen me katër aspekte kryesore si në vijim:

- Qëndrueshmëria;
- Parandalimi;
- Zvogëlimi;
- Bashkëpunimi në funksion të zbatimit të planit dhe programit.

Organizimi i punës sipas këtyre aspekteve të cilat janë të pandashme dhe njëkohësisht krijojnë sinergji, ka ndikuar në ngritjen e vëmendjes së zyrtarëve publikë, shoqërisë civile dhe odave të biznesit mbi rëndësinë dhe kujdesin që duhet t'i jepet barrës administrative për qytetarë dhe biznese. Po ashtu, kjo qasje ka plotësuar edhe procese tjera të digjitalizimit me qëllim përmirësimin e shërbimeve, të paraqitura në Strategjinë për Reformën e Administratës Publike dhe Strategjinë për Qeverisje Elektronike, të miratuara nga Qeveria. Duke marrë për bazë analizimin e gjendjes aktuale në këtë fushë, të fokusuar në kornizën për zhvillimin e politikave publike (strategji, koncept dokumente dhe legjislacion), burimet njerëzore (politikëbërëse, ligjore, teknologjike) dhe kulturën administrative të administratës publike në vend, qasja strategjike për zbatimin e Programit është zhvilluar në atë mënyrë që t'i përshtatet kësaj gjendjeje të analizuar.

- Disa prej aspekteve apo fjalëve kyçe të kësaj qasjeje (të cilat janë të shprehura në Program, mirëpo disa janë edhe të zhvilluara gjatë procesit të zbatimit) janë si në vijim:
- Planifikimi dhe pronësia e procesit;

Për një zbatim të suksesshëm të Programit, është centralizuar planifikimi dhe koordinimi dhe është decentralizuar pronësia dhe zbatimi. Në këtë mënyrë, ministritë kanë marrë të gatshme planet dhe mbështetjen me ekspertizë nga qendra (prej idesë deri te mbështetja për hartimin apo ndryshimin e politikave dhe legjislacionit, deri te zhvillimi i sistemeve dhe mirëmbajtja e tyre për periudhë dy vjeçare), ndërsa kanë ud-

hëhequr dhe kanë pronësinë e reformës në proces duke i dizajnuar shërbimet në atë mënyrë që mundësojnë zvogëlimin e barrës për qytetarë dhe biznese, por edhe për zvogëlimin e kostos së ofrimit të shërbimeve nga institucionet përkatëse. Disa raste që mund të cekën në këtë fazë janë nw MD, MMPHI, AKK, MKRS, etj.

- Thjeshtim dhe digjitalizim në të njëjtën kohë

Qasja e re strategjike është zhvilluar në atë drejtim që thjeshtimi dhe digjitalizimi të bëhen në të njëjtën kohë. Duhet theksuar se, sipas praktikave të vendeve tjera, zakonisht është bërë thjeshtimi pastaj digjitalizimi, mirëpo qasja e re strategjike e Programit, ka marrë rrugë drejt thjeshtimit dhe digjitalizimit në të njëjtën kohë, duke nxitur digjitalizimin si motivues për thjeshtim. Kjo vjen si rezultat i gjendjes aktuale në administratën publike, e cila karakterizohet nga vonesa në ndryshim të legjislacionit dhe nga kultura administrative e vjetëruar.

- Kombinimi i temave dhe zyrtarëve

Duke marrë për bazë kulturën administrative të administratës publike, si shpesh të izoluar në trajnimin e proceseve të ndryshme që dërgojnë në një rezultat të vetëm (shërbimi për qytetarë dhe biznese) qasja e re strategjike po ashtu është zhvilluar në drejtim të kombinimit të temave dhe zyrtarëve publikë për çështjen e njëjtë. Në këtë aspekt, grupet punuese, trajnimet, forumet apo ngjarjet e ndryshme janë organizuar në atë mënyrë që zyrtarët që hartojnë politika publike, zyrtarët ligjorë dhe zyrtarët për teknologji informative janë bërë bashkë, si për marrjen e trajnimit për procesin e barrës administrative, ashtu edhe gjatë procesit,

për diskutimin dhe zbatimin e aktiviteteve për arritjen e rezultateve të njëjta.

- Bashkëpunimi: nga avokimi në zbatim

Zakonisht në vendet tjera, disa prej analizave, matjeve apo identifikimit të metodologjive dhe ideve, bëhen nëpërmjet bashkëpunimit të Qeverisë me universitetet. Duke marrë për bazë mungesën e kapaciteteve në administratën publike, për disa prej aspekteve të rëndësishme për zbatimin e Programit, siç janë analizat, matjet dhe identifikimi i metodologjive dhe praktikave të mira, qasja e re ka përfshirë po ashtu bashkëpunimin për zbatim me organizatat e shoqërisë civile dhe odat e biznesit në mënyrë që procesi të avancojë nga bashkëpunimi për avokim në bashkëpunimin për zbatim. Në këtë kontekst, siç është theksuar në Raport (shih kapitullin Bashkëpunimi), disa prej analizave, matjeve apo mbikëqyrjeve si aktivitete të Programit, janë zbatuar më mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile apo odave të biznesit.

- Ngritja e vëmendjes brenda administratës

Ngritja e vëmendjes për barrën administrative brenda administratës është një prej aspekteve më të rëndësishme të qasjes së Programit. Kjo është duke u bërë vazhdimisht nëpërmjet trajnimeve, dizajnimit dhe punës së përbashkët dhe grupeve punuese apo forumeve të përbashkëta.

Siç u theksua më lartë dhe siç do të detajohet më poshtë në Raport, moduli i ri trajnues ka rezultuar që shërben edhe për ngritje të vëmendjes për procesin e barrës administrative dhe për të mirat në punë që kanë zyrtarët në rast se parandalojnë apo zvogëlojnë barrë dhe nëse digjitalizojnë procese. Po ashtu, një prej metodave

për vëmendje është procesi i dizajnit të përbashkët të shërbimeve apo mendimit kreativ, ku zyrtarët sipas grupeve dhe profileve të ndryshme, mësojnë, diskutojnë dhe krijojnë prototipe të shërbimeve duke pasur përdoruesin në qendër dhe duke dizajnuar në atë mënyrë që lehtëson punën e tyre gjatë procesit.

Të gjitha këto aspekte kanë lehtësuar dhe mundësuar zbatimin e Programit deri më tani dhe do ta vazhdojnë ta mundësojnë këtë edhe në vazhdim.

2. QËNDRUËSHMERIA

Një nga aspektet kryesore për zbatimin e Programit është sigurimi i qëndrueshmërisë. Ky aspekt është i nevojshëm dhe kyç për ndikimin në kulturën administrative në zhvillimin dhe dizajnimin e politikave publike (strategji, koncept dokumente dhe legjislacion) për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe biznese, me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të barrës administrative.

Në kontekst të sigurimit të qëndrueshmërisë, për zbatimin e Programit, janë marrë masa në katër drejtime, si mekanizmat, mjetet, ekspertiza dhe trajnimet.

2.1. MEKANIZMAT

Themelimi apo funksionalizimi i mekanizmave për zbatimin e Programit është fokusuar në dy nivele: politik dhe operativ (qendror dhe lokal). Sa i përket nivelit politik, sikurse theksohet në Program, është mbledhur dy herë brenda vitit KPS, i kryesuar nga Kryeministri. Në kuadër të këtij komisioni, si përgjegjës politik mbi procesin e barrës administrative ishte ZVKM, ndër-


sa si anëtar të KPS ishin ministrat përkatës vëmendja e të cilëve ishte e nevojshme për të shtyrë zbatimin e Programit. Po ashtu, KPS përbëhet edhe nga Sekretaria operative e cila mbulohet nga ZPS e ZKM. Hierarkia e përgjegjësisë së KPS, është sipas figurës si në vijim:

Figura 1: Hierarkia e përgjegjësisë institucionale



Në kuadër të nivelit operativ, themelimi i mekanizmave është fokusuar në tri nivele: ZKM, institucione qendrore dhe komuna, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 1: Themelimi i mekanizmave në funksion të zbatimit të Programit



Nr.	Aktiviteti	Ndërlidhja me Program	Institucioni	Treguesi i zbatimit
1	Emërimi i Koordinatorit të Procesit të Barrës Administrative me vendim të Qeverisë	PV 3.1	Qeveria	1 Koordinator për procesin e barrës administrative është emëruar me vendim të Qeverisë.
2	Emërimi i zyrtarëve përgjegjës në nivel qendror për procesin e barrës administrative me vendim të Sekretarëve të Përgjithshëm	PV 3.2	Ministritë e Linjës	20 zyrtarë përgjegjës për procesin e barrës administrative në nivel qendror janë emëruar nga Sekretarët e Përgjithshëm apo nga Drejtorët e Agjencive Ekzekutive relevante.
3	Emërimi i zyrtarëve përgjegjës në nivel lokal për procesin e barrës administrative me vendim të Kryetarëve të Komunave	PV 3.3	MAPL, Komunat	32 zyrtarë përgjegjës për procesin e barrës administrative në nivel lokal janë emëruar me vendim të Kryetarëve të Komunave.
4	Organizimi i takimeve të Komisionit për Planifikim Strategjik	PV 5.2	ZPS	Janë organizuar dy takime të KPS të kryesuara nga Kryeministri ku është diskutuar me ministrat e linjës për shtytjen para të procesit të barrës administrative.

2.2. MJETET

Zhvillimi, hartimi apo përmirësimi i mjeteve të ndryshme që e bënë të mundshme zbatimin e Programit, përfshirë analiza, metodologji, udhëzues, katalogë, etj., të cilat mundësojnë zbatimin e Programit, janë zhvilluar sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 2: Zhvillimi, hartimi dhe përmirësimi i mjeteve me qëllim zbatimin e Programit

Nr.	Aktiviteti	Ndërlidhja me Program	Institucioni	Treguesi i zbatimit
1	Analiza për identifikimin e mangësive dhe sfidave në zhvillimin e koncept dokumenteve	PV 3.9	ZPS	Analiza është përfunduar dhe janë identifikuar mangësitë dhe sfidat për zhvillimin e koncept dokumenteve, si dhe janë dhënë propozimet për evitimin e tyre nëpërmjet përditësimit të Udhëzuesit për Koncept Dokumente, ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores së Punës së Qeverisë, listës së kontrollit, testit filtrues dhe koordinimit të procesit.
2	Zhvillimi i Mostrës shtesë për Udhëzuesin për koncept dokumente me qëllim përfshirjen e procesit të barrës administrative	PV 3.9	ZPS	Mostra shtesë për Udhëzuesin për koncept dokumente është përfunduar dhe e gatshme për përdorim.

3	Analiza për përditësimin e udhëzuesit për zhvillimin e memorandumeve shpjeguese	PV 3.12	ZPS	Analiza për përditësimin e Udhëzuesit për zhvillimin e memorandumeve shpjeguese është përfunduar dhe propozimet për Udhëzuesin e ri për memorandume shpjeguese janë ofruar duke u bazuar në nevojat e institucioneve tona dhe praktikën e BE.
4	Hartimi i udhëzuesit të ri për hartimin e memorandumeve shpjeguese	PV 3.12	ZPS	Drafti i Udhëzuesit për hartimin e memorandumeve shpjeguese është i përfunduar.
5	Zhvillimi i metodologjisë për zbatimin e parimit të personalizim në thjeshtim dhe digjitalizim të shërbimeve	PPZBA 1.2.	ZPS, ASHI	Metodologjia për personalizimin e shërbimeve është përfunduar, ku janë identifikuar parimet, qasjet, metodat dhe hapat për personalizimin e shërbimeve, të cilat duhet të ndiqen përgjatë dizajnit të shërbimeve, si në aspekt rregullator ashtu edhe në atë digjital.
6	Zhvillimi i udhëzuesit për MKS dhe Skedarëve Excel	PV 3.10	ZPS	Udhëzuesi i ri për MKS i përfunduar dhe i gatshëm për përdorim.
7	Zhvillimi elektronik i Skedarëve Excel të MKS.	PV 3.11	ZPS	Është zhvilluar koncepti për zhvillimin e Skedarit Excel të MKS dhe ka filluar puna mbi digjitalizimin e aplikacionit.
8	Zhvillimi i udhëzuesit për zbatimin e parimit të mbulueshmërisë së kostos dhe Skedarit Excel	PPZBA 2.2.1	ZPS	Udhëzuesi i ri për zbatimin e parimit të mbulueshmërisë së kostos i përfunduar dhe i gatshëm për përdorim për matjet e shpenzimeve të administratës në ofrimin e shërbimeve.
9	Zhvillimi elektronik i Skedarit Excel për zbatimin e parimit të mbulueshmërisë së kostos	PPZBA 2.2.1	ZPS	Është zhvilluar koncepti për zhvillimin e aplikacionit për zbatimin e parimit të mbulueshmërisë së kostos në mënyrë digjitale dhe ka filluar punë për digjitalizim.
10	Zhvillimi i testit filtrues për politikat publike	PPZBA 2.	ZPS	Testi filtrues për politikat publike është përfunduar dhe i gatshëm për përdorim.

2.3. EKSPERTIZA



Duke marrë për bazë mungesën e kapaciteteve njerëzore në ZKM dhe institucione tjera, një nga aspektet më të rëndësishme është sigurimi i ekspertizës së nevojshme të jashtme e siguruar dhe kontraktuar nga partnerët zhvillimorë, për mbështetjen e ZKM dhe të institucioneve zbatuese. Sikurse më lartë, edhe në sigurimin e ekspertizës, qasja e Programit ka motivuar sigurimin e një 10 ekspertize diverse, duke përfshirë ekspertizën ligjore, atë për hartimin e politikave, për digjitalizim dhe atë për komunikim.

Ekspertët afatgjatë apo konsulentët tjerë afatshkurtër, janë mbështetje e procesit, si për parandalim dhe zvogëlim të barrës administrative, ashtu edhe për trajnim të zyrtarëve publikë të nivelit qendror dhe lokal. Duhet të theksohet se ekspertët ligjorë dhe të politikave janë nën koordinimin e ZPS dhe në mbështetje të institucioneve të cilat zbatojnë Programin, ndërsa zhvilluesit dhe eksperti për siguri kibernetike janë nën koordinimin e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (tash e tutje ASHI) dhe sipas nevojës edhe të ZPS, në mbështetjen të procesit të barrës administrative në kontekst të digjitalizimit.

2.4. TRAJNIMET

Trajnimi i zyrtarëve publikë të nivelit qendror dhe lokal ka filluar nga muaji shtator 2023, pas zhvillimit të modulit të ri, materialeve shoqëruese dhe testeve të vlerësimit në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (tash e tutje IKAP). Në modulën e ri, si u theksua shkurtimisht më lartë, është ndjekur qasja e kombinuar, përfshirë komponentët kryesor për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative: modeli i kostimit standard (tash e tutje MKS), vlerësimi i ndikimit rregullator (koncept dokumentet), parimet e procedurave të përgjithshme administrative që lidhen ngushtë me barrën administrative, hartimi ligjor dhe dizajnimin kreativ të shërbimeve, koncept i ri i iniciuar në administratë publike. Këta komponentë janë të shoqëruara me pjesë konceptuale, si definimi i barrës administrative dhe digjitalizimi në funksion të barrës administrative apo zhvillimi i politikave publike që mundësojnë digjitalizimin. Aktivitetet të cilat janë përfunduar në funksion të ngritjes së vetëdijes së zyrtarëve publikë përmes trajnimeve, janë si në vijim:

Tabela 3: Aktivitetet në funksion të ngritjes së kapaciteteve dhe vetëdijes së zyrtarëve publikë nëpërmjet trajnimeve




Nr.	Aktiviteti	Ndërlidhja me Program	Institucioni	Treguesi i zbatimit
1	Analiza e detajuar e trajnimeve që ofrohen në IKAP në kontekst të barrës administrative dhe identifikimi i nevojave dhe profileve për trajnim për barrë administrative	PV 3.7	ZPS, IKAP	Analiza është përfunduar e cila ka identifikuar trajnimet aktuale në IKAP dhe ndërlidhja e tyre me barrën administrative, e cila po ashtu ka dhënë mënyrën e trajnimit për barrë administrative.
2	Përgatitja e profileve dhe listës së zyrtarëve për pjesëmarrje në trajnime	PV 3.7	ZPS	Profilat e zyrtarëve për trajnim është përfunduar. Lista ka filluar të përgatitet, e cila do të përmbajë zyrtarët publikë nga ministritë, agjencitë dhe komunat.
3	Përgatitja e materialit trajnues, përfshirë manualin, prezantimet, ushtrimet dhe testet e trajnimit, sipas Programit.	PV 3.7	IKAP, ZPS	Moduli i trajnimit për procesin e parandalimit dhe zvogëlimit të barrës administrative është përfunduar dhe ka filluar së zbatuari.
4	Organizimi i trajnimeve për zyrtarët publikë të nivelit qendror dhe lokal	PV 3.13 dhe 3.14	IKAP, ZPS	Janë organizuar 4 runde trajnimesh për vitin 2023, me gjithsej 65 zyrtarë në nivel qendror dhe lokal dhe është bërë planifikimi për vitin 2024 për rreth 400 zyrtarë tjerë.
5	Analiza e politikë bërjes dhe ndikimit të TIK në barazinë gjinore dhe zhvillimi i konceptit të trajnimit për ndikimin e TIK në barazinë gjinore	PPZBA 3	ZPS	Koncepti është përgatitur i cili informon zyrtarët publikë mbi mënyrat e përfshirjes së perspektives gjinore në elemente të ndryshme të procesit të barrës administrative.
6	Përgatitja e modulit të trajnimit për aspektin e barazisë gjinore për politikë bërje dhe zhvillimin e TIK	PPZBA 3	ZPS	Është përgatitur drafti i modulit i cili është i gatshëm për konsultim me palët e interesuara për t'u integruar në modulën për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative.

Pjesëmarrja në trajnim ka qenë dhe është duke vijuar si e kombinuar, që nënkupton se zyrtarët me funksione të ndryshme janë duke e ndjekur trajnimin e njëjtë përnjëherë, ku janë duke u ndarë sfidat, problemet, pyetjet, mësimet dhe përvojat mes tyre. Kjo qasje e kombinuar ka rezultuar se motivon interaktivitetin, e cila bënë që trajnimi të jetë i dobishëm për krijimin e qëndrueshmërisë institucionale në funksion të parandalimit dhe zvogëlimit të barrës administrative. Kjo qasje, mes tjerash, është duke shërbyer

edhe për ngritjen e vëmendjes së zyrtarëve publikë për procesin e barrës administrative. Trajnimet janë duke u organizuar sipas prioritizimit institucional, jo më shumë se dy trajnime në muaj dhe jo më pak se pesë ditë për trajnim, ku përfshihen tre ditë për parandalim dhe zvogëlim të barrës administrative dhe dy ditë për dizajnim të shërbimeve (Design Thinking). Trajnimi përcillet me një test të njohurive, në fillim dhe në fund të trajnimit, për vlerësimin e ndikimit të trajnimit. Duhet theksuar se zyrtarët


e parë që janë trajnuar janë zyrtarët përgjegjës për barrën administrative në nivel qendror dhe lokal të caktuar me vendim të Sekretarëve të Përgjithshëm të Ministrive, Drejtorëve të Agjencive ekzekutive relevante dhe Kryetarëve të Komunave. Po ashtu, në këtë numër të zyrtarëve të trajnuar, kanë marrë pjesë edhe zyrtarë të cilët janë të përfshirë drejtpërdrejtë në procese dhe aktivitete për parandalim dhe zvogëlim të barrës administrative gjatë vitit 2023 dhe që do të vazhdojnë të përfshihen edhe gjatë vitit 2024. Sipas mbajtjes së trajnimeve gjatë periudhës shtator-dhjetor 2023, janë nxjerrë 12 rezultatet e mëposhtme (të cilat do të mund të detajohen dhe plotësohen në raportin e ardhshëm që përfshinë edhe pjesëmarrjen e zyrtarëve tjerë në trajnim). Të dhënat për pjesëmarrjen në trajnim dhe testim, kalueshmërinë dhe ndikimin e trajnimit në bazë të testit vlerësues, të zbërthyer në nivel qendror dhe lokal dhe sipas gjinisë, janë si më poshtë:

Figura 2: Pjesëmarrja në trajnim nga niveli qendror dhe lokal, ndarë sipas gjinisë



Siç tregojnë të dhënat nga Figura 1, është një shifër jo e kënaqshme e pjesëmarrjes në trajnim të grave në nivel lokal (18%) dhe kjo e ka ulur numrin e përgjithshëm të grave në trajnimin për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative (37%).


Figura 3: Pjesëmarrja dhe performanca në testim, si total



Siç shihet në *Figurën 2*, përqindja (%) e atyre që nuk kanë kaluar testin është e vogël (11% apo 7 zyrtarë nuk e kanë kaluar testin) në krahasim me ata që kanë kaluar (66% apo 43 zyrtarë e kanë kaluar testin), mirëpo një përqindje më e lartë është e atyre që nuk janë testuar (23% apo 15 zyrtarë nuk janë testuar). Duke u bazuar në sfidat e diskutuara në trajnim, një prej aspekteve kryesore të mos testimit në fillimin e trajnimit, pra në trajnimet e para, është edhe për shkak se disa prej temave të procesit të parandalimit dhe zvogëlimit të barrës administrative janë tërësisht të panjohura për ta dhe kjo shfaq pasiguri për testim. Mirëpo, për këtë do të punohet në rritje të vetëdijes dhe komunikimit, në mënyrë që tema e barrës administrative, të mos jetë diçka e re.


Po ashtu, siç vërehet nga *Figura 3*, përqindje (%) më e vogël e grave (42%) kanë kaluar testin në krahasim me burrat (58%). *Figura 5: Rezultatet e testimit vlerësues*

Figura 4: Kalueshmëria në testim, ndarë sipas gjinisë



Po ashtu, siç vërehet nga *Figura 3*, përqindje (%) më e vogël e grave (42%) kanë kaluar testin në krahasim me burrat (58%).

Figura 5: Rezultatet e testimit vlerësues



Pjesa më e rëndësishme e matjes së rezultatit të testimit vlerësues të trajnimit është diferenca ndërmjet përgjigjeve të sakta të testeve të trajnimit, të cilat bëhen një herë në fillim dhe një herë në fund. Siç tregojnë të dhënat e mësipërme, rezulton se gratë kanë performuar më mirë se burrat. Sikurse në testin e parë, ashtu edhe në testin e dytë, kanë arritur pikë më shumë se burrat, ndonëse ndikimi apo diferenca mes testit të parë dhe testit të dytë është e njëjtë, me 20 pikë përqindjeje të të dyja gjinitë. Prandaj, siç rezulton nga të dhënat e paraqitura në figurat më lartë, për trajnimin në tërësi, njohuritë bazike të zyrtarëve (burra e gra bashkë) të trajnuar rezultojnë të arrijnë vetëm në 48% në testim të parë, ndërsa 68% në testim të dytë. Pra, rezultati i testimit të dytë vlerësues është 20% rritje. Në përgjithësi, diferenca mes testimit të parë dhe të dytë prej 20% tregon një sukses në trajnim. Mirëpo, në kontekst të qëndrueshmërisë së procesit dhe në përgjithësi në kontekst të gjendjes institucionale në vend për ofrimin e shërbimeve, këto shifra janë të ulëta. Në këtë aspekt, do të ndërmerren hapa tutje, që kjo përqindje të rritet me anë të trajnimeve më intensive dhe në disa nivele, si dhe me metoda të tjera që rrisin fokusin në proces. Sidoqoftë, duhet të theksojmë se për një performancë edhe më të mirë dhe për të kuptuar edhe më të mirë të proceseve, përveç trajnimit, është i nevojshëm edhe zhvillimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse për ngritjen e kapaciteteve për barrë administrative, përfshirë informimi i duhur i zyrtarëve publikë, vetë-mësimi, e-trajnimi, përkrahja e drejtpërdrejtë në punë (coaching), etj.

3. PARANDALIMI


Sigurimi i qëndrueshmërisë që u theksua më lartë, është aspekt kyç në parandalimin e barrës administrative në politika publike, qofshin ato strategji apo koncept dokumente, qofshin ato ligje apo akte nënligjore. Qëndrueshmëria në proces motivon punën sistematike drejt arritjes së reformës së dëshiruar. Në këtë kontekst, që nga muaji qershor 2023, Qeveria nëpërmjet ZPS të ZKM, ka ndërmarrë dhe përsëritur disa masa dhe aktivitete për parandalimin e barrës administrative.

Tabela 4: Aktivitetet të cilat janë ndërmarrë në kontekst të parandalimit:

Nr.	Aktiviteti	Ndërlidhja me Program	Institucioni	Produkti – Rezultati - Progresi
1	Zhvillimi i listës kontrolluese në kontekst të parandalimit dhe zvogëlimi të administrative zhvillimit të dokumenteve barrës përgjatë koncept	PPZBA 1.5 & 2.2.2	ZPS	Lista kontrolluese është përfunduar ku janë identifikuar çështjet kyçe që duhet të përmbajë një koncept dokument në kontekst të barrës administrative.
2	Kontrolli i vazhdueshëm i koncept dokumenteve në kontekst të barrës administrative	PPZBA 2.2.2	ZPS, SKQ	20 koncept dokumente janë kontrolluar dhe komentuar gjatë zhvillimit dhe gjatë konsultimeve.
3	Kontrolli i vazhdueshëm i legjislacionit në kontekst të barrës administrative	PPZBA 2.1	ZPS, ML	14 projektligje dhe 43 projekt akte nënligjore janë kontrolluar dhe komentuar gjatë konsultimeve.
4	Zhvillimi i metodologjisë për zbatimin e parimit “një brenda, një jashtë”	PV 3.17	ZPS	Zhvillimi i metodologjisë për zbatimin e parimit “një brenda, një jashtë” ka filluar, metodologji e cila do të përmbajë elemente kyçe që duhet të ndiqen në zbatim të këtij parimi.
5	Identifikimi i lejimeve kyçe për të cilat ka më shumë popullim dhe frekuencë prej grave dhe të rinjve.	PPZBA 1.5	ZPS	Identifikimi ka filluar dhe do të përmbajë lejimet kyçe të cilat popullohen dhe frekuentohen më së shumti nga gratë dhe të rinjtë.
6	Zhvillimi i pasaportës informative të biznesit	PV 1.18	ZPS, MINT	Pasaporta informative e biznesit është përgatitur si draft i parë dhe është e gatshme për konsultim me palët e interesuara. Pasaporta ofron udhëzime navigimi në rrugën e ndërmarrësisë për ide, regjistrim, zhvillim, zgjerim, etj., në Kosovë.

Këto masa fokusohen në kontrollin e politikave publike (koncept dokumente dhe legjislacion) gjatë zhvillimit të tyre apo gjatë konsultimeve, si një procedurë e zakonshme e shprehur me rregullat në fuqi.


3.1. KONCEPT DOKUMENTET



Në këtë kontekst, sa i përket koncept dokumenteve, duke u bazuar në listën e kontrollit të zhvilluar enkas për procesin e ndikimit rregullator, kontrollet dhe intervenimet në kontekst të barrës administrative janë fokusuar në: përmbledhje, hyrje, përkufizim të problemit, objektiva, opsione, vlerësim të ndikimit, komunikim dhe konsultim, krahasim të opsioneve, plan të zbatimit, etj., gjithmonë sipas nevojës dhe natyrës së çështjes që trajton koncept dokumenti. Pyetjet të cilat kanë qenë orientim për komentet dhe intervenimet në koncept dokumente fokusoheshin në parimet e procedurës së përgjithshme administrative si, parimi i mbulueshmërisë së kostos, parimi i joformalizmit, parimi i qarkullimit njëherësh të të dhënave (once only), parimi i proporcionalitetit, etj., të cilat kursejnë kohë dhe para për qytetarët dhe bizneset.


Procesi i kontrollit dhe intervenimeve në koncept dokumente, ka rezultuar në statistikat si më poshtë:

Figura 5: % e koncept dokumenteve të shqyrtuara, relevante dhe jo relevante për barrën administrative



Pra, siç vërehet në figurë, 50 % të koncept dokumenteve, apo 10 koncept dokumente, kanë rezultuar që janë relevante në kontekst të barrës administrative dhe në këto koncept dokumente është adresuar barra administrative në forma të ndryshme, duke u fokusuar në kapitujt kryesorë, siç janë përkufizimi i problemit, caktimi i objektivave dhe opsioneve, identifikimi i ndikimeve dhe planifikim. Në të shumtën e rasteve, ekipi i ZPS dhe SKQ në ZKM, u kanë ndihmuar institucioneve të linjës të analizojnë implikimet e barrës administrative në koncept dokumentet përkatëse, përmes konsultimit me grupet punuese. Intervenimet e bëra në koncept dokumente janë të dobishme në dy drejtime: 1) për vëmendjen e zyrtarëve hartues të koncept dokumentit për barrë administrative e cila vëmendje do të reflektohet edhe në politikën pasuese të koncept dokumentit; dhe 2) miratimi i koncept dokumenteve nga Qeveria, e bënë obliguese adresimin e barrës administrative gjatë hartimit të legjislacionit. Duhet theksuar se një pjesë e koncept dokumenteve të trajtuara janë ende në proces të zhvillimit sipas procedurave ligjore në fuqi, ndërsa një pjesë e tyre janë miratuar nga Qeveria.

3.2. LEGJISLACIONI



Sa i përket pjesës së legjislacionit, si atij primar ashtu edhe atij dytësor, Qeveria e Kosovës nëpërmjet ZPS të ZKM, kanë marrë disa masa për parandalimin e barrës administrative, duke kontrolluar legjislacionin gjatë fazës së konsultimeve paraprake në kontekst të barrës administrative. Kontrolli dhe komentet në legjislacion janë fokusuar në aspekte të ndryshme të parandalimit

dhe zvogëlimit të barrës administrative dhe qeverisjes së mençur, si:


- *Dizajnimi i shërbimit;*
- *Parimi i mbulueshmërisë së kostos;*
- *Qarkullimin njëherësh i të dhënave (once only);*
- *Aspekteve të gatishmërisë për digjitalizim, etj.*

Sidoqoftë, duhet theksuar se ky kontroll nuk është fokusuar në aspektin e ligjshmërisë apo kushtetutshmërisë së legjislacionit të kontrolluar. Pra, kontrolli dhe komentimi është fokusuar në parimet e qeverisjes së mençur (smart governance). Kur kemi të bëjmë me legjislacionin në kontekst të barrës administrative, duhet pasur parasysh një aspekt se, duke u bazuar në gjendjen e terrenit, legjislacioni i cili mbulon shërbimet e ndryshme, ndryshohet me rrallë dhe jo vetëm në kontekst të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, por për aspekte tjera.

Prandaj, nuk është e rastësishme edhe një përqindje e ulët e legjislacionit që është relevant dhe është kontrolluar e komentuar në kontekst të barrës administrative. Pra, institucionet nuk kanë qasje proaktive sa i përket ndryshimit të legjislacionit vetëm për përmirësimin e shërbimeve dhe për këtë ekziston dhe është planifikuar zvogëlimi i barrës administrative. Në këtë kontekst, qasja strategjike e Programit, do të lehtësoj ndryshimin e tyre, nëpërmjet koordinimit të centralizuar të procesit. Sidoqoftë, në vitin 2024 do të evidentohet legjislacioni i planifikuar relevant për barrën administrative dhe do të kontrollohet, komentohet dhe intervenohet gjatë fazës së zhvillimit, duke detajuar pastaj në raportin tjetër edhe nivelin e kursimit të kostos dhe elementeve tjera statistikore gjatë parandalimit të barrës administrative. Duke marrë për bazë këtë, nga

periudha qershor – dhjetor 2023, nga kontrolli i legjislacionit primar (14 projektligje) dhe dytësor (43 projekt akte nënligjore), gjithsej rezulton si në vijim:


Figura 6: Legjislacioni primar dhe sekondar me dhe pa implikime për barrën administrative.



Siç theksohet në figurën më lartë, pas kontrollit të legjislacionit që ka kaluar nëpër ZKM, rezulton se 57% të legjislacionit primar ka poseduar barrë administrative dhe është komentuar në kontekst të saj. Ndërkaq, në rastin e legjislacionit dytësor që është kontrolluar e komentuar gjatë konsultimeve nga ekipi i ZPS, figuron se 44% të legjislacionit dytësor të kontrolluar ka poseduar barrë administrative. Statistikat më lartë jepen në formë të kufizuar për shkak të fillimit të vonë të zbatimit të qasjes së kontrollit, pra nga qershori 2023. Mirëpo, për vitin 2024 dhe në raportin tjetër, do të jenë edhe statistika tjera si, sektorët, tipat e shërbimeve dhe kostoja e parandalimit, pasi që për këtë do të bëhet kontrolli edhe pas miratimit.

Statistikat më lartë jepen në formë të kufizuar për shkak të fillimit të vonë të zbatimit të qasjes së kontrollit, pra nga qershori 2023. Mirëpo, për vitin 2024 dhe në raportin tjetër, do të jenë edhe statistika tjera si, sektorët, tipat e shërbimeve dhe kostoja e parandalimit, pasi që për këtë do të bëhet kontrolli edhe pas miratimit.

4. ZVOGËLIMI



Zvogëlimi i barrës administrative është fokusuar në nivel qendror dhe lokal duke përfshirë fazën përgatitore dhe fazën operative për thjeshtim dhe digjitalizim të shërbimeve. Përgatitja për thjeshtim dhe digjitalizim të shërbimeve përfshinë analizimin e legjislacionit dhe gjendjes rregullatore, duke propozuar rekomandimet e nevojshme për intervenim. Po ashtu, analizimi i gjendjes aktuale të kornizës digjitale dhe si ajo duhet të zhvillohet, nëpërmjet metodës “Si është, si të jetë” (AS IS, TO BE).

Ndërsa sa i përket digjitalizimit që ka filluar në disa institucione, janë ndjekur disa prej hapave apo parimeve të mëposhtme:

- është analizuar procesi në tërësi sipas perspektives së përdoruesve;
- është zhvilluar prototipi dhe është testuar me përdorues;
- është zhvilluar sistemi fundor duke ndjekur prototipin final;
- është hartuar korniza ligjore duke ndjekur prototipin digjital;
- është përdorur e-Kosova si dritare e vetme për ofrimin e shërbimeve;
- është ndjekur parimi “vetëm njëherë”.

4.1. MASAT DHE AKTIVITETET PËR THJESHTIM DHE DIGJITALIZIM NË NIVEL QENDROR

Masat dhe veprimet për thjeshtimin dhe digjitalizimin e shërbimeve në nivel qendror që janë ndërmarrë në kuadër të zbatimit të Programit, janë si më poshtë:

Tabela 5: Aktivitetet e realizuara në funksion të thjeshtimit dhe digjitalizimit në nivel qendror

Nr.	Aktiviteti	Ndërlidhja me Program	Institucioni	Produkti – Rezultati - Progresi
1	Zhvillimi i katalogut të shërbimeve në nivel qendror	PPZBA 3	ZPS, ASHI	Katalogu i shërbimeve në nivel qendror është zhvilluar. Janë hulumtuar 80 institucione, janë identifikuar rreth 750 shërbimeve, për secilin shërbim 23 pyetje.
2	Analiza dhe vlerësimi i infrastrukturës digjitale në administratën qendrore	PV 1.10	ZPS, ASHI	Analiza është përfunduar me anë të së cilës është identifikuar dhe analizuar gatishmëria e infrastrukturës aktuale për digjitalizim të proceseve për lejime.
3	Analiza dhe vlerësimi i arkitekturës së ndërveprueshmërisë digjitale të administratës qendrore	PV 1.10	ZPS, ASHI	Analiza është përfunduar me anë të së cilës është vlerësuar ndërveprueshmëria aktuale digjitale në administratën qendrore dhe janë dhënë rekomandimet e përmirësimit të saj.

4	Analiza dhe vlerësimi i legjisla- cionit për digjitalizim në adminis- tratën qendrore	PV 1.10	ZPS, ASHI	Analiza është përfunduar me anë të secilës është vlerë- suar gjendja e tanishme rregullore në kontekst të digjitalizimit dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësim.
5	Metodologjia për gatishmëri institucionale për digjitalizim dhe prioritizim të shërbimeve	PV 1.10	ZPS, ASHI	Metodologjia për gatishmëri institucionale për digjitalizim dhe prioritizim të shërbimeve është finalizuar dhe është e përdorshme për adminis- tratën publike.
6	Analiza dhe vlerësimi i gatishmërisë së ministrive për digjitalizim	PV 1.10	ZPS, ASHI	Analiza dhe vlerësimi i gatishmërisë së ministrive që lëshojnë më së shumti lejime është përfunduar dhe është duke u përdorur në ato lejime të përzgjedhura për thjeshtim dhe digjitalizim
7	Identifikimi dhe analizimi i reg- jistrave qendror elektronik dhe shërbimeve GG	PV 1.10	ZPS, ASHI	Regjistrat qendror elek- tronik janë identifikuar dhe analizuar në kontekst të përshtatshmërisë me siste- min GG.
8	Mjeti për prioritizimin e shërbi- meve për digjitalizim	PV 1.10	ZPS, ASHI	Mjeti për prioritizim të shër- bimeve është përfunduar dhe i gatshëm për përdorim nga ana administrata publike.
9	Analiza “AS IS, TO BE” e shërbi- meve të MASHT, MINT, ARRH, ARKEP, MD, AKPPM, MSH dhe MMPHI	PV 1.10	ZPS, ASHI	Analiza e 30 shërbimeve është përfunduar
10	Analiza e detajuar “AS IS, TO BE” për noterizimin digjital	PV 1.10	ZPS, ASHI	Analiza për noterizimin digji- tal është përfunduar dhe e njëjta është përdorur për ta hartuar ligjin për noterinë sa më miqësor ndaj digjital- izimit.
11	Zhvillimi i metodologjisë për shërbimet që mund të ofrohen në mënyrë digjitale e për të cilat nuk ka nevojë nënshkrimi elektronik	PPZBA 3	ZPS, ASHI	Metodologjia është zhvil- luar dhe është e gatshme përdorim nga institucionet relevante.
12	Zhvillimi i aplikacionit për Qen- drën e Thirrjeve të ATK-së për menaxhimin e thirrjeve hyrëse nga tatimpaguesit	PV 1.15	ATK, ZPS	Aplikacioni për thirrjet hyrëse planifikohet të përfundohej dhe të integrohet me platfor- mat tjera relevante në ATK në muajin shkurt 2024.

13	Analiza e nevojave dhe përvojave të tatimpaguesve lidhur me komunikimin dhe shërbimet e ofruara nga ATK	PV 1.15	ZPS, ATK	Analiza e nevojave dhe përvojave është përfunduar nga kompania kontraktore dhe e njëjta ka dhënë rezultatet sipas të cilave është ndërtuar edhe koncepti për mbështetjen e klientëve në ATK.
14	Zhvillimi i konceptit për përditësimin dhe modernizimin e ofrimit e shërbimeve për klientë në ATK	PV 1.15	ZPS, ATK	Koncepti parasheh ndryshimet e nevojshme në ATK sa i përket procedurave dhe zgjidhjeve lidhur me komunikimin dhe shërbimet me tatimpagues Konceptit do t'i paraprijë anketa me tatimpagues të kategorive të ndryshme e cila tenton të mat ndjesinë/p përvojën e tatimpaguesve lidhur me shërbimet e ofruara nga ATK-ja
15	Përgatitja e projektligjit omnibus për thjeshtimin e lejimeve që ofrohen nga MBPZHR, MMPHI, MSH dhe MPB, MD, MASHTI, MFPT, ME dhe MKRS	PV 1.1 – 1.4	ZL, MBPZHR, MMPHI, MSH, MPB, MD, MASHTI, MFPT, ME dhe MKRS	Projektligji omnibus ka kaluar fazën e konsultimeve dhe është finalizuar si draft nga mbështetja e partnerit zhvillimor. Ka qenë i planifikuar të miratohet në Qeveri në nëntor 2023, mirëpo, i njëjti është shtyrë për TM4 2024.
16	Analiza për thjeshtimin e lejimeve që ofrohen nga organet e pavarura: AAC, KPM, ZRRE, BQK, ARRH, KPMM, ARKEP dhe ARRU.	PV 1.7	ZL	Analiza për thjeshtimin e lejimeve që ofrohen nga organet e pavarura është në prag të finalizimit. E njëjta gjatë tremujorit të parë 2024 do të miratohet në Qeveri.
17	Zhvillimi i Udhëzuesit për Informim Publik për Inspektime	PPZBA 1	ZIP, ZPS	Udhëzuesi është i përfunduar dhe i gatshëm për përdorim.
18	Zhvillimi i tre (3) Udhëzuesve për Inspektime: 1) Për kërkesat e detyrueshme të të dhënave për regjistrimin e inspektimeve dhe raportimin në nivele të ndryshme brenda sistemit të inspektoratit, 2) përditësimi i listave të kontrollit të bazuara në vlerësimin e rrezikut dhe 3) inspektimet e përbashkëta.	PPZBA 1	ZIP, ZPS	Ka filluar puna për zhvillimin e tre udhëzuesve, të cilët do të zhvillohen duke marr inpute nga takimet me Inspektoratet qendrore, të cilët do të rrisin cilësinë e kërkesave të detyrueshme të të dhënave dhe raportimit brenda sistemit të inspektorateve, dhe do të theksojnë uljen e barrës administrative dhe rritjen e transparencës. Për secilin udhëzues janë mbajtur punëtoritë e veçanta me grupe të inspektorateve qendrore me qëllim të prezantimit të metodologjive të punës duke prezantuar edhe praktikatat më të mira ndërkombëtare që mund të jenë të zbatueshme në Kosovë.

19	Zhvillimi i Analizës për Vlerësimin e Ndikimit të Inspektimeve Rregullatore në Bizneset Kosovare	PPZBA 1	ZIP, ZPS	Analiza e Vlerësimit të Ndikimit të Inspektimeve Rregullatore në Bizneset Kosovare është zhvilluar duke u konsultuar me fokus grupet e organizuara me biznese dhe janë identifikuar ndikimet kryesore të inspektimeve rregullatore te bizneset kosovare.
20	Zhvillimi i Udhëzuesit për hartimin dhe zbatimin e mekanizmave të ankesave për kërkesat dhe ankesat e inspektimit të palëve të treta, me qëllim të promovimit të inspektimeve të shkaktuara nga palët e treta.	PPZBA 1	ZIP, ZPS	Është zhvilluar drafti i udhëzuesit për nxitjen e inspektimeve me kërkesë të palëve të treta dhe i gatshëm për përdorim.
21	Analiza e detajuar ligjore dhe e proceseve sipas metodës "AS IS, TO BE" për leje ndërtimore të kategorisë 1, 2 dhe 3	PV 2.4	MMPHI, ZPS	Analiza është përfunduar bashkë me MMPHI dhe 3 Komuna: Prishtina, Prizreni dhe Suhareka.
22	Zhvillimi i konceptit për thjeshtimin dhe digjitalizimin e shërbimeve të punësimit	PV 1.14	ZPS, APRK	Ka filluar zhvillimi i konceptit për thjeshtimin dhe digjitalizimin e shërbimeve të punësimit që ofrohen nga APRK, që së shpejti do të jetë i gatshëm për të vazhduar me hapat e parë drejt digjitalizimit në APRK.
23	Koncepti rreth thjeshtimit të shërbimit të pajisjes me letërnjoftim për qytetarët e Kosovës	PV 2.10	ZPS, ARC	Koncepti ka përfunduar dhe sipas të njëjtit do të filloj ndërhyrja në përmirësim të ofrimit të letërnjoftimit për qytetarë.
24	Digjitalizimi i plotë i marrjes së Certifikatës së Evidencës Penale dhe ekspozimit të saj në e-Kosova	PV 2.6	KGJK, ASHI, ZPS	Certifikata për evidencën penale është digjitalizuar në tërësi, e cila mund të shkarkohet nga e-Kosova.
25	Zhvillimi digjital i aplikimit për subvencione dhe grante në MBPZHR	PV 1.12	ZPS, MBPZHR	Sistemi mini-fundor është përfunduar. Mbetet që MBPZHR të vendos se kur do të filloj të fut në përdorim aplikacionin e zhvilluar. Diskutimi me Ministrin e MBPZHR për zhvillimin e plotë e të gjitha sistemeve fundore të MBPZHR.
26	Analiza për gjendjen aktuale rregullatore të shërbimeve ligjore të MD: provimin e jurispruencës dhe licencimin e avokatëve, certifikimin dhe licencimin e ndërmjetësuesve, përmbauesve privat, administratorëve falimentues dhe noterëve.	PV 1.11	ZPS, MD	Analiza është përfunduar në tërësi dhe në bazë të saj është zhvilluar prototipi për digjitalizim.
27	Zhvillimi i prototipit digjital për sistemin digjital për shërbimet ligjore të MD: provimin e jurispruencës dhe licencimin e avokatëve, certifikimin dhe licencimin e ndërmjetësuesve, përmbauesve privat, administratorëve falimentues noterëve.	PV 1.11	ZPS, MD	Prototipi digjital është zhvilluar dhe testuar me zyrtarë dhe kandidatë dhe i njëjti do të përdoret për zhvillimin e sistemit fundor në MD.

28	<p>Hartimi i plotësimeve dhe ndryshimeve të akteve nënligjore të MD që rregullojnë shërbimet ligjore që ofron MD:</p> <ol style="list-style-type: none"> Propozimet për ndryshime në Udhëzim Administrativ MD - Nr. 06/2022 për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit të jurispruencës Propozimet për ndryshime në Udhëzim Administrativ MD - Nr. 03/2019 për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës Propozimet për ndryshime në Udhëzimin Administrativ MD – Nr. 03/2017 për procedurat e organizimit, përmbajtjes dhe mbajtjes së provimit për administratorë falimentues Propozimet për ndryshime në Udhëzimin administrativ Nr. 02/2013 për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit për përmbartuesit privat Propozimet për ndryshime në Udhëzim Administrativ MD - Nr. 01/2019 për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit për Noterinë Propozimet për ndryshime në Udhëzim Administrativ MD - Nr. 06/2019 Për Trajnimin dhe Certifikimin e Ndërmjetësuesve 	PV 1.11	MD, ZPS	Draftet finale të UA për shërbimet ligjore në MD janë hartuar dhe dorëzuar në MD dhe janë në proces të konsultimeve paraprake. Të njëjtat do të dërgohen në konsultim publik dhe pastaj do të miratohen nga Ministri dhe në këtë mënyrë të lejojnë mundësinë e ofrimit të këtyre shërbimeve në formën digjitale.
29	Zhvillimi i sistemit fundor digjital i shërbimeve ligjore që ofron MD: provimin e jurispruencës dhe licencimin e avokatëve, emërimin dhe licencimin e ndërmjetësuesve, përmbartuesve privat, administratorëve falimentues dhe noterëve.	PV 1.11	MD, ZPS	Sistemi fundor digjital dhe integrimi në e-Kosova i shërbimeve ligjore që ofron MD është në proces të zhvillimit nga kompania e kontraktuar.
30	Analiza për gjendjen aktuale rregullatore të shërbimeve për shërbimet gjeodezike, licencimin e gjeodetëve, kompanive gjeodezike, gjeodetëve teknik dhe qasja në stacione permanente.	PV 1.11	ZPS, AKK	Analiza është përfunduar në tërësi dhe në bazë të saj është zhvilluar prototipi për digjitalizim
31	Zhvillimi i sistemit fundor digjital për shërbimet gjeodezike që ofron MMPHI: licencimin e gjeodetëve, kompanive gjeodezike, gjeodetëve teknik dhe qasja në stacione permanente.	PV 1.11	AKK, ZPS	Sistemi fundor digjital dhe integrimi në e-Kosova i shërbimeve gjeodezike që ofron MMPHI është në proces të zhvillimit nga kompania e kontraktuar.
32	Analiza për aplikimin e Direktivës për Shërbime të BE për shërbimet ligjore dhe shërbimeve që ndërlidhen me patentë shofer.	PV 1.11	ZPS, MMPHI	Analiza është përfunduar dhe është identifikuar lidhshmëria e shërbimeve që ndërlidhen me patentë shofer me Direktivën e BE për Shërbime.

33	Analiza për gjendjen aktuale rregullatore për shërbimet që ndërlidhen me patentë shoferin: licencimi i auto shkollave, instruktorëve të shoferëve, pyetëseve dhe ligjërueseve profesional.	PV 1.11	ZPS, MMPHI	Analiza është përfunduar në tërësi dhe në bazë të saj është zhvilluar prototipi për digjitalizim.
34	Zhvillimi i prototipit digjital për sistemin digjital për shërbimet që ndërlidhen me patentë shoferin: licencimi i auto shkollave, instruktorëve të shoferëve, pyetëseve dhe ligjërueseve profesional.	PV 1.11	ZPS, MMPHI	Prototipi digjital është zhvilluar dhe testuar me zyrtarë dhe kandidatë dhe i njëjti do të përdoret për zhvillimin e sistemit fundor në MMPHI.
35	Zhvillimi i sistemit fundit digjital për shërbimet që ofron MMPHI që ndërlidhen me patentë shoferin: shkollave, shoferëve, ligjërueseve profesional. licencimi i auto instruktorëve të pyetëseve dhe	PV 1.11	MMPHI, ZPS	Sistemi fundor digjital i shërbimeve që ndërlidhen me patentë shoferin që ofron MMPHI është në proces te prokurimit.
36	Analiza për gjendjen aktuale rregullatore të Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve (OAI) në fushën e ndërtimit	PV 1.11	ZPS, OAI	Analiza është përfunduar në tërësi dhe në bazë të saj ka filluar hartimi i akteve nënligjore të nevojshme për rregullimin e shërbimeve të OAI dhe digjitalizimin e tyre.
37	Hartimi i akteve nënligjore të OAI për shërbimet që ofron OAI: 1. Statuti i Përkohshëm i Odës; 2. Kodi i Përkohshëm i Etikës dhe Sjelljes Profesionale; 3. Rregullore qe përcakton lartësinë dhe mënyrën e sigurimit të përgjegjësive profesionale për dëmet të cilat mund t'i shkaktojë arkitekti dhe inxhinieri i licencuar gjatë kryerjes së veprimeve të lejuara me licencën e marrë; 4. Rregullore për përpilimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave të Odës; 5. Rregullore për procedurën për licencimin, ri-licencimin, mirëmbajtjen, pezullimin, revokimin e licencës; 6. Rregullore për procedurën disiplinore ndaj anëtareve të Odës; 7. Rregullore për procedurën për njohjen e licencave të lëshuara jashtë vendit;	PV 1.11	ZPZ, OAI	Draftet e akteve nënligjore të OAI janë të përfunduara, të cilat presin shqyrtimin final nga OAI, para se të dalin në konsultime paraprake dhe publike.

38	Zhvillimi i Portalit të Transparencës dhe digjitalizimit të procesit të Regjistrimit të Furnitorëve në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	PPZBA 3	MFPT, ZPS	Procesi për zhvillimin e Portalit të Raportimit dhe Llogaridhënies dhe digjitalizimit të Regjistrimit të Furnitorëve ka filluar, me të cilin synohet publikimi i të dhënave të mbi 100 organizatave buxhetore dhe 3000 përdoruesve fundor, portal ky që synon promovimin dhe rritjen e besimit të qytetarëve me Qeverinë, dhe rritjen e transparencës së Qeverisë.
39	Thjeshtimi dhe digjitalizimi i shërbimeve për subvencione dhe grante në MKRS.	PPZBA 3	MKRS, ZPS	Ka filluar thjeshtimi dhe digjitalizimi i proceseve për grante dhe subvencione në MKRS, të cilat përmblihen në 15-20 thirrje dhe kanë mesatarisht 1500 aplikime secila prej tyre.

4.2. MASAT DHE AKTIVITETET PËR THJESHTIM TË SHËRBIMEVE NË NIVEL LOKAL

Sa i përket thjeshtimit të shërbimeve komunale, duhet theksuar se intervenimi është më i kufizuar, për shkak të kompetencave vetanake të komunës por edhe për shkak të gatishmërisë së ulët për ndryshim, si në komuna ashtu edhe në nivel qendror kur ky i fundit mund të ketë ndikim. Për këtë qëllim, intervenimet në shërbimet e komunave më së shumti janë në kosto, apo pagesa administrative për shërbime, ndonëse ka edhe intervenime si në eliminim apo bashkim të shërbimeve, kur ato janë pa bazë ligjore apo kur baza ligjore e lejon të njëjtën. Masat dhe veprimet përgatitore dhe operative për thjeshtimin e shërbimeve në nivel lokal që janë ndërmarrë në kuadër të zbatimit të Programit, janë si më poshtë:

Tabela 6: Aktivitetet e realizuara në funksion të thjeshtimit të shërbimeve në nivel lokal

Nr.	Aktiviteti	Ndërlidhja me Program	Institucioni	Produkti - Rezultati - Progresi
1	Përgatitja e konceptit dhe metodologjisë për thjeshtimin e shërbimeve në komuna	PPZBA 6	ZPS	Koncepti është përfunduar dhe përmban metodologjinë mbi thjeshtimin e shërbimeve në nivel komunal.
2	Zhvillimi i katalogut të shërbimeve në nivel lokal	PPZBA 6	ZPS, ASHI	Katalogu i shërbimeve në nivel lokal është zhvilluar. Janë hulumtuar 20 komuna dhe janë identifikuar mesatarisht 100 shërbimeve për secilën komunë.

3	Analiza për thjeshtimin e shërbimeve në komunën e Ferizajt	PV 4.1	Komuna e Ferizajt, ZPS	Analiza është përfunduar e cila përmban të gjitha propozimet për thjeshtimin e pagesave administrative të shërbimeve komunale, eliminimin e shërbimeve të cilat nuk kanë bazë ligjore dhe bashkimin apo ndarjen e shërbimeve përkatëse.
4	Zbatimi i rekomandimeve të dala nga analiza për thjeshtimin e shërbimeve në Komunën e Ferizajt	PV 4.2	Komuna e Ferizajt, ZPS	Zbatimi i analizës për thjeshtimin e shërbimeve që ofron komuna e Ferizajt është përfunduar dhe ndikimi i këtij zbatimi jepet më poshtë te pjesa e matjes së ndikimit.
5	Analiza për thjeshtimin e shërbimeve në komunën e Pejës	PV 4.1	Komuna e Pejës, ZPS	Analiza është përfunduar e cila përmban të gjitha propozimet për thjeshtimin e pagesave administrative të shërbimeve komunale, eliminimin e shërbimeve të cilat nuk kanë bazë ligjore dhe bashkimin apo ndarjen e shërbimeve përkatëse.
6	Zbatimi i rekomandimeve të dala nga analiza për thjeshtimin e shërbimeve në Komunën e Pejës	PV 4.2	Komuna e Pejës, ZPS	Zbatimi i analizës për thjeshtimin e shërbimeve që ofron komuna e Pejës është në përfundim të zbatimit. Në bazë të dakordimit, pritet që Rregullorja për përcaktimin e pagesave të hyj në fuqi në fillim të vitit 2024, me ndryshimet e propozuara.
7	Zhvillimi i rubrikës E-Komunat brenda platformës E-Kosova	PV 4.8	ASHi MAPL	Rubrika është zhvilluar brenda platformës e-Kosova.


4.3. MATJA E ZVOGËLIMIT TË BARRËS ADMINISTRATIVE NË NIVEL QENDROR DHE LOKAL

Zvogëlimi i barrës administrative në nivel qendror dhe lokal përgjatë viteve 2022 dhe 2023, sipas qasjes së Programit, u fokusua në disa institucione dhe në disa elemente. Institucionet në nivel qendror të cilat janë kampione në zvogëlimin e barrës administrative janë MINT, MPB, MMPHI dhe MB-PZHR, ndërsa komunat të cilat prijnë në zvogëlimin e barrës administrative **janë Prizreni, Ferizaji dhe Peja**. Elemente të cilat prijnë në zvogëlimin e barrës administrative të shërbimeve të këtyre institucioneve janë:

- *eliminimi i shërbimit,*
- *bashkimi i shërbimeve,*
- *eliminimi i dokumenteve të ndryshme,*
- *zgjatja e vlefshmërisë së dokumenteve,*
- *zvogëlimi i pagesave administrative duke përfillur parimin e mbulimit së kostos, etj.*

Matja është bërë nëpërmjet Modelit të Kostimit Standard.

NIVELI QËNDROR



Në bazë të matjeve, zvogëlimi i barrës administrative në nivel qendror nga ana e ministrive apo agjencive të tyre vartëse, për periudhën qershor 2022 – 2023, rezulton si më poshtë:

Tabela 7: Numri i shërbimeve të thjeshtuara në katër ministri dhe kursimet pas thjeshtimit


	MINT	MPB	MMPHI	MBPZHR	Totali
Shërbime të thjeshtuara	32	14	2	1	49
Kursime vjetore pas thjeshtimit	657,855 €	920,820 €	12,791 €	10,298 €	1,601,764 €

Duhet të theksojmë se, siç tregon tabela 7, MINT ka thjeshtuar më shumë shërbime për nga numri, por MPB e tejkalon për nga kursimet, pasi që shërbimet e thjeshtuara në MPB kanë numër aplikimesh shumë më të lartë sesa ato në MINT. Inventarizimi i shërbimeve të thjeshtuara nga MINT dhe agjencitë e saj vartëse, pastaj të MMPHI, MBPZHR dhe MPB, ku shfaqen vetëm një numër i kufizuar informatash, me theks të veçantë të zvogëlimi i pagesave administrative dhe jo edhe elementet tjera të thjeshtuara, është si në Shtojcën 1 dhe 2 të këtij Raporti.

NIVELI LOKAL

Në bazë të matjeve, zvogëlimi i barrës administrative në nivel lokal, rezulton si më poshtë:

Tabela 8: Numri i shërbimeve të thjeshtuara, eliminuara dhe kursimet, në dy komuna



	Prizren	Ferizaj	Pejë	Totali
Shërbime të thjeshtuara	37	50	16	103
Shërbime të eliminuara	25	26	13	64
Kursime vjetore pas thjeshtimit dhe eliminimit	422,852 €	42,100 €	163,736 €	628,688 €

Sikurse te niveli qendror, edhe në rastin e nivelit lokal kemi gjendjen e ngjashme. Ndonëse Komuna e Ferizajt ka një numër më të madh të thjeshtimeve, për nga kur-

simet Komuna e Prizrenit dhe ajo e Pejës janë shumë më përpara, për shkak të numrit shumë të lartë të aplikimeve.

Inventarizimi i shërbimeve të thjeshtuara nga Komuna e Prizrenit, Komuna e Ferizajt dhe Komuna e Pejës, ku shfaqen vetëm një numër i kufizuar informatash, me theks të veçantë të zvogëlimi i pagesave administrative dhe jo edhe elementet tjera të thjeshtuara, është si në Shtojcën **3, 4 dhe 5**, të këtij Raporti.

Po ashtu, duhet të theksojmë se në mungesë të kapaciteteve të ZPS, puna në terren me komunën e Prizrenin, Komunën e Ferizajt dhe Komunën e Pejës, është bërë në koordinim dhe me mbështetjen e plotë të ekspertizës së projektit “Përsheptimi i klimës së investimeve”, i zbatuar nga Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC).

5. BASHKËPUNIMI

Bashkëpunimi me palët e treta për zbatimin e Programit është një nga aspektet kyçe për arritjen e rezultateve. Në këtë aspekt, ZPS ka zgjeruar bashkëpunimin për zbatimin e Programit me partner të ndryshëm zhvillimorë, shoqërinë civile, odat e biznesit dhe partnerët e huaj strategjik të fushës. Sa i përket bashkëpunimit më shoqërinë civile, qasja e re e Programit orientoi bashkëpunimin nga avokimi për zbatim në zbatimin e vet Programit.

Sa i përket bashkëpunimit me odat e biznesit, qasja e re e Programit orientoi bashkëpunimin me to, në drejtim të afrimit të anëtarësisë së tyre në dizajnimin e politikave publike nëpërmjet zbatimit të parimit të personalizimit dhe metodës së bashkë-dizajnit. Për këtë qëllim, në vitin 2024 do të bëhen përpjekje të krijohen apo do të përdoren forumet e odave të biznesit për komentim, dizajnim dhe orientim të politikave publike drejt përmirësimit të ofrimit të shërbimeve me përdoruesin në qendër.

Sa i përket bashkëpunimit me partnerët e huaj strategjik, si me OECD/SIGMA, E-Governance Academy, etj., është shtuar bashkëpunimi, nëpërmjet përfshirjes së tyre, jo vetëm në këshillim por edhe në zbatim të aktiviteteve të ndryshme, siç është rasti i Kampeve Digjitale, konferencën regjionale për barrë administrative, apo aspekteve të tjera të fokusuara në këshillim dhe orientim strategjik.

Në këtë kontekst, nga shtatori 2022, janë zbatuar aktivitetet si në vijim:

Tabela 9: Aktivitetet e ndërmarra në bashkëpunim me shoqërinë civile, odat e biznesit dhe partnerët e jashtëm

Nr.	Aktiviteti	Ndërlidhja me Program	Institucioni	Produkti – Rezultati - Progresi
1	Mbajtja e Kampit të Parë Digjital për ngritjen e kapaciteteve të shërbyesve civilë me njohuri për digjitalizimin inteligjencën artificiale dhe	PV 3.15	ZPS, GIZ, E-Governance Academy dhe Open Data Kosovo	Kampi Digjital është mbajtur në bashkëpunim me e-Governance Academy të Estonisë dhe me Open Data Kosovo, ku kanë marrë pjesë 50 zyrtarë, 23 prej tyre gra (46%) dhe 27 burra (54%)
2	Zhvillimi i konceptit dhe përgatitja për mbajtjen e konferencës regjionale për barrën administrative	PV 5.4 dhe 5.5	ZPS, GIZ, OECD/SIGMA	Konferenca është në përgatitje e sipër, e cila do të mbahet në bashkëpunim me OECD/SIGMA, në shkurt 2024.
3	Vizita studimore në Estoni për konferencën e organizuar nga E-Governance Academy me titull "Digitalization as Catalyst for Social Change".	PPZBA 7.3	ZPS, ML, GIZ, E-Governance Academy	Vizita studimore është kryer me sukses. Përgjatë vizitës, pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të takohen dhe shkëmbejnë informata me institucione si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjenci të Teknologjisë Informative, Regjistri Civil, si dhe organizata jo-qeveritare.
4	Mbajtja e takimit me shoqërinë civile dhe me Ministrinë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural për digjitalizimin e aplikimit për subvencione dhe grante	PV 5.8	GLPS, INDEP, GAP, ZPS, MBPZHR	Takimi është mbajtur me organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e institucioneve relevante, i organizuar nga GLPS, INDEP dhe GAP.
5	Zhvillimi i konceptit për bashkëpunimin me odat e bizneseve në kontekst të barrës administrative	PV 5.6	ZPS	Koncepti për bashkëpunim me odat e bizneseve është përfunduar dhe është mbajtur takimi me Oden Ekonomie Gjermano-Kosovare (tash e tutje OEGJK)

6	Analiza për ofrimin e shërbimeve të orientuara kah përdoruesi në Kosovë	PPZBA 3	D+, ZPS	Analiza është përfunduar dhe shërben si një udhërrëfyes i vlefshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), si dhe Komuna e Ferizajit.
7	Analiza mbi ndikimin e digjitalizimit të shërbimeve të gjendjes civile në të hyrat buxhetore të komunave	PPZBA 3	Instituti GAP, ZPS	Analiza e bërë nga Instituti GAP dhe ZPS tregon ndikimin buxhetor që ka zvogëlimi i barrës administrative në komuna
8	Aplikimi në kuadër të Instrumentit të Para Anëtarësimit (IPA 2024) për Mbështetje Sektoriale Buxhetore (SBS) me vlerë prej 20 milionë eurove, nën titullin "Thjeshtimi dhe digjitalizimi i shërbimeve".	PPZBA 7.3	ZPS	ZPS nën mbikëqyrjen e Zëvendëskryeministrit të Parë, ka aplikuar për Mbështetje Buxhetore Sektoriale në Bashkimin Evropian në kuadër të IPA 2024.
9	Mbajtja e takimeve me anëtarësinë e odave të biznesit për barrën administrative të shkaktuar nga inspektimet	PV 5.6	ZIP, ZPS, OEGJK	Janë mbajtur dy takime me biznese (anëtarësinë e OEGJK) mbi barrën administrative e shkaktuar nga inspektimet.
10	Mbajtja e takimit me shoqëri civile, odat e bizneseve dhe bizneset për barrën administrative në Administratën Tatimore të Kosovës dhe takimin digjital	PV 5.6 dhe PV 5.8	D+, ZPS, ATK	Është mbajtur takimi me odat e biznesit dhe bizneset, i organizuar nga D+, në panel me ZPS dhe ATK, ku është biseduar mbi evidentimin e barrës administrative në ATK dhe si të zvogëlohet ajo.
11	Mbajtja e takimit me shoqëri civile dhe institucionet relevante për zvogëlimin e barrës administrative për Regjistrimin e Automjeteve, Vazhdimin e Regjistrimit dhe Ndërrimin e Pronësisë.	PV 5.6 dhe PV 5.8	GLPS, ZPS	Është mbajtur takimi me organizatat e shoqërisë civile, partnerët zhvillimorë dhe institucionet relevante, i organizuar nga GLPS, në panel me ZPS dhe GLPS.
12	Analizimi i tre "ngjarjeve jetësore" për jetesën, studimin dhe punësimin në Kosovë, në kuadër Single Digital Gateway në Ballkanin Perëndimor	PPZBA 1.5 & 3	OECD/SIGMA, ZPS	Bashkë me OECD/SIGMA ka filluar studimi i tri ngjarjeve jetësore në Kosovë, "të jetosh", "të punosh" dhe "të studiosh" në Kosovë.
13	Vizita studimore në Mbretëri të Bashkuar për konferencën e "Prosperity & Protection - effective regulation for growth, trade and innovation"	PPZBA 7.3	ZPS, ZIP, IFC	Vizita është kryer me sukses, ku pjesëmarrësit patën rastin të njoftohen me zhvillimet me të fundit në fushën e digjitalizimit të shërbimeve dhe planeve të shteteve tjera në këtë fushë.

SHTOJCA 1: LISTA E SHËRBIMEVE TË THJESHTUARA NË MINT, MMPHI DHE MBPZHR

Dëshminë e thjeshtimit të shërbimeve që ka zbatuar MINT, MMPHI dhe MBPZHR, të paraqitura në këtë shtojcë, gjenden në aktet ligjore të renditura më poshtë. Duhet të theksojmë se thjeshtimi i këtyre shërbimeve nuk është kufizuar vetëm në pagesat administrative, por edhe në dokumente, kërkesa, vlefshmëri, etj., të cilat nuk janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Për 32 shërbimet e MINT dhe agjencie vartëse:

- Udhëzim Administrativ (MINT) Nr. 04/2022 për caktimin e lartësisë së tarifave për leje të subjekteve për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme
- Udhëzim Administrativ (MINT) Nr. 06/2022 për lartësinë dhe procedurën e pagesës për shërbimet në metrologji
- Udhëzim Administrativ (MINT) Nr. 09/2022 për lartësinë e tarifave për kontrollimin dhe shënjimin e punimeve nga metalet e çmuara
- Udhëzim Administrativ (MINT) Nr. 12/2022 për caktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve
- Udhëzim Administrativ (MINT) Nr. 13/2022 për përfaqësues të autorizuar për pronësi industriale
- Udhëzim Administrativ (MINT) Nr. 13/2022 për përfaqësues të autorizuar për pronësi industriale

Për shërbimet e MMPHI:

- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina
- Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr. 10/2022 për kontrollin teknik të automjeteve

Për shërbimet e MBPZHR:

- Ligji Nr. 04/L-041 për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit

Ministra e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë			
Nr	Shërbimi	Pagesa administrative	
		Para thjeshtimit	Pas thjeshtimit (2022)
1	Leje për import të dizelit dhe benzinës	3,000 €	50 €
2	Leje për deponim të dizelit, benzinës dhe gazoilit	1,000 €	50 €
3	Leje për shitje me shumicë të dizelit, benzinës dhe gazoilit	2,000 €	50 €
4	Leje e shitjes me pakicë të dizelit, benzinës dhe bio-karburanteve	1,000 €	50 €
5	Leje e importit të gazit të lëngëzuar të naftës	2,000 €	50€
6	Leje e deponimit të gazit të lëngëzuar të naftës	1,000 €	50 €
7	Leje e shitjes me shumicë të gazit të lëngëzuar të naftës	1,500 €	50 €
8	Leje e shitjes me pakicë të gazit të lëngëzuar të naftës	500 €	50 €
9	Leje e importit, deponimit dhe shitjes së gazoilit për nxehe	5,000 €	50€
10	Leje e importit dhe shitjes së vajrave të rënda për ngrohje	2,000 €	50€
11	Leje e importit, deponimit dhe shitjes së vajgurit/kerozines	3,000 importi; 1,000 deponimi	50€
12	Leje e importit dhe shitjes së koksit të naftës	1,000 €	50€
13	Leje e importit, deponimit dhe shitjes së produkteve të caktuara të vajrave për qëllime të tjera	1,000 €	50€
14	Leje e importit të lëndës së parë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve të naftës	5,000 €	50€
15	Leje e importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të bombolave të gazit për amvisëri	500 €	50 €
Agjencia e Metrologjisë së Kosovës (AMK)			
16	Autorizimi i subjekteve juridike për riparimin dhe përgatitjen e mjeteve matëse për verifikim.	400 €	260 €
17	Certifikata për testimin dhe miratimin e tipit të mjetit matës	20 € per h	10 € per h
18	Autorizimi/emërimi i subjekteve juridike për verifikim e mjeteve matëse ligjore	Verifikimi i mjeteve matëse në qendrat e kontrollit teknik të automjeteve – 800 €	450 €
		Verifikimi i taksimetrave dhe tahografëve – 600 €	450 €
		Verifikimi i mjeteve matëse tjera ligjore – 600 €	450 €
19	Ekzaminimi me analiza kimike të punimeve nga metalet e çmuara	Analiza kimike e arit: 16.00 € per cope	Për punimet: • 0-1000gr = 18.90 €; • 1001- 5000gr = 33.70 €; • > 5000gr = 48.60 €.
		Analiza kimike e argjendit: 16.00 € për copë	
Agjencia për Regjistrimin e Biznesit të Kosovës (ARBK)			
20	Harmonizimi ose rifreskimi në tërësi i statutit ose memorandumit për shoqëri aksionare (SH.A), shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K), ortakëri të kufizuar (O.K), Dega e shoqërisë së huaj tregtare (D.SH.H.T) dhe kooperativat bujqësore (K.B)	10 €	5€

21	Regjistrimi dhe çdo ndryshim i njësisë për SH.A, SH.P.K, O.K, D.SH.H.T dhe K.B	10€	5€
22	Bartja e emrit zyrtar dhe emrit tregtar të biznesit për SH.A, SH.P.K, O.K, D.SH.H.T dhe K.B	10€	5€
23	Ndryshimi i adresës dhe emrit të biznesit për SH.A, SH.P.K, O.K, D.SH.H.T dhe K.B	10 €	5€
24	Ndryshimi i pronarëve, ndryshimi i kapitalit dhe vlerës së aksioneve për SH.A, SH.P.K, O.K, D.SH.H.T dhe K.B	10 €	5€
25	Ndryshimi i veprimtarive të biznesit për SH.A, SH.P.K, O.K, D.SH.H.T dhe K.B	10 €	5€
26	Ndryshimi i tipit të biznesit, bashkimi ose ndarja e shoqërisë tregtare për SH.A, SH.P.K, O.K, D.SH.H.T dhe K.B	10€	5€
27	Vërtetim lidhur me biznesin, pronarin apo drejtorin për SH.A, SH.P.K, O.K, D.SH.H.T dhe K.B	2€	1€
28	Ndryshimi i adresës dhe emrit të biznesit për biznes individual (B.I) dhe ortakëri të përgjithshme (O.P)	5€	2.5€
29	Regjistrimi dhe çdo ndryshim i njësisë për B.I dhe O.P	5€	2.5€
30	Ndryshimi i formës së biznesit nga B.I në O.P apo e kundërta	5€	2.5€
31	Vërtetim lidhur me biznesin, pronarin apo drejtorin për B.I dhe O.P	2€	1€
Agjencia e Metrologjisë së Kosovës (AMK)			
32	Regjistrimi apo vazhdimi i regjistrimit në regjistër të përfaqësuesve të autorizuar	Regjistrimi – 250 € Vazhdimi – 250 €	200 € 200 €
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës			
33	Leja për menaxhimin e mbeturinave është shkruirë 500 € në Lejen Mjedisore	500 €	0 €
34	Licenca për kontrollin teknik të automjeteve	3000 €	180 €
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural			
35	Leja për importin e duhanit	/	/


SHTOJCA 2: LISTA E SHËRBIMEVE TË THJESHTUARA NË MPB

Ndërsa sa i përket 14 shërbimeve të thjeshtuara të MPB, respektivisht ARC, duhet të theksojmë disa aspekte të rëndësishme. Thjeshtimi dhe kalkulimi i kursimeve për certifikatat e gjendjes civile fokusohet në heqjen e kopjeve të dokumenteve personale si kërkesa nga institucioni. Në kohën e konsultimeve të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 01/2022 për dokumentet e gjendjes civile [<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=53355>], tashmë në fuqi, ZPS në bashkëpunim dhe me mbështetjen e IFC, ka komentuar dhe argumentuar se kërkesa e kopjes së dokumentit personal që lëshohet nga vet institucioni duhet të largohet nga UA. MPB është përgjigjur pozitivisht

komentit dhe ka larguar nga UA kopjet e dokumenteve personal si kërkesa për shërbime. Pas hyrjes në fuqi, ZPS me mbështetjen e projektit të IFC, në muajin mars 2023, ka realizuar një anketë me qytetarë në 6 komuna, ku janë bërë 3 pyetje. Pyetja e tretë si në tabelë, apo se sa minuta u ka marrë kohë kopjimi i dokumentit personal, është bërë me të vetmin qëllim për matje të ndikimit dhe zvogëlimit të kohës dhe shpenzimeve gjatë procedurave.

Shërbimet e gjendjes civile	Pagesa administrative		
	Për çfarë dokumenti keni aplikuar?	A u është kërkuar kopja e letërnjoftimit?	Sa minuta mendoni se u janë kursyer?
1. Drejtoria e Administratës - Komunat: Prishtina, Prizreni, Ferizaji, Gjilani, Gjakova dhe Klina			
1.Certifikatë e lindjes 2.Ekstrakt i lindjes 3.Certifikatë e martesës 4.Certifikatë e statusit martesor 5.Certifikatë shtetësie 6.Certifikatë e bashkësisë familjare 7.Certifikatë e vdekjes 8.Regjistrimet e mëvonshme e të lindurve në institucionet shëndetësore që kanë kaluar afatin ligjor 30 ditë 9.Regjistrimet e mëvonshme e të lindurve që kanë kaluar moshën 12 vjeçare 10. Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes 11. Ndërrimi i emrit personal 12. Korrigjime dhe plotësime në regjistrin civil (korrigjimi i emrit personal, etj.) 13. Fitimi (regjistrimi) i shtetësisë së Kosovës 14. Humbja e shtetësisë së Kosovës	Ekstrakt i lindjes (40%) Certifikatë e lindjes(30%) Certifikatë e bashkësisë familjare (20%) Certifikatë e martesës (20%)	Të gjithë të anketuarit janë përgjigjur me JO.	Mesatarja e përgjigjeve: 5.2 minuta.

[Ndonëse për procedurë apo për qytetarë është një shumë e vogël e parave dhe një kohë e shkurtër që kursehet, duke marrë parasysh numrin tejet të lartë të aplikimeve (mbi 2 milionë në tërë Kosovën) për të gjitha certifikatat e gjendjes civile, shuma e kursimit del të jetë shumë e madhe. Natyrisht, në këtë kalkulim nuk është llogaritur kursimi në kohë dhe shpenzime i digjitalizimit të disa prej certifikatave të gjendjes civile nëpërmjet platformës e-Kosova.



SHTOJCA 3: LISTA E SHËRBIMEVE TË THJESHTUARA NË KOMUNËN E PRIZRENIT

Dëshmitë mbi thjeshtimin e shërbimeve të Komunës së Prizrenit, të inventarizuara më poshtë, gjenden në Rregullore 02/2022 për taksat komunale, miratuar nga Kuvendi Komunal me datë 20 qershor 2022, e publikuar me 7 korrik 2022.

Duhet të theksojmë se thjeshtimi i këtyre shërbimeve nuk është kufizuar vetëm në pagesat administrative, por edhe në dokumente, kërkesa, vlefshmëri, etj., të cilat nuk janë të paraqitura në tabelën së mëposhtme gjendjes civile

Komuna e Prizrenit			
Nr	Shërbimi	Pagesa administrative	
		Para thjeshtimit	Pas thjeshtimit
1	Certifikatë e statusit martesort	5€	1 €
2	Certifikatë vendbanimi	2.5 €	1 €
3	Certifikatë për lajmërim apo ç 'lajmërim të vendbanimit	2.5 €	1 €
4	Certifikatë e bashkësisë familjare	2.5 €	1 €
5	Akti i vdekjes	5€	2€
6	Regjistrimet e mëvonshme e të lindurve jashtë institucioneve shëndetësore brenda territorit të Kosovës që kanë kaluar moshën 12 vjeçare	30€	20 €
7	Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes në institucionet shëndetësore brenda territorit të Kosovës	50€	20€
8	Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes jashtë institucioneve shëndetësore brenda territorit të Kosovës	60€	50€
9	Regjistrimet e mëvonshme të vdekjeve kur nuk është regjistruar lindja dhe vdekja	60 €	50€
10	Korrigjimi i emrit personal	5 €	2 €
11	Leje për hyrje në shatërvan (për biznese)	20€	0€
12	Leje për taksi individual	250 €	60€
13	Vazhdimi i lejes për taksi (pagesë vjetore)	70€	20€

14	Leje për operatorë lokal për transport të udhëtarëve (pagesë çdo 5 vjet)	500 €	150 €
15	Taksa për gjerim të rrugëve me asfalt	50€/m'	20 € / m'
16	Taksa për gjerim të rrugëve me kube	20€/m'	10 € / m'
17	Taksa për gjerim të sipërfaqeve të gjelbra	10€/m'	0€
18	Vlerësimi i dëmit të pyjeve, vreshtave, pemishteve dhe pasurive tjera bujqësore	10 €	0 €
19	Certifikatë për prodhues bujqësorë nga lëmi e bujqësisë dhe hidro-ekonomisë	2.5 €	0 €
20	Kërkesë për kontroll inspektues në qytet dhe jashtë qytetit nga persona fizikë dhe juridik	10 €	0 €
21	Kërkesë për verifikimin e fazave ndërtimore me protokoll se a janë duke u kryer punimet ndërtimore sipas lejes ndërtimore në objektet për banim individual	10 €	0€
22	Kërkesë për verifikimin e fazave ndërtimore me protokoll se a janë duke u kryer punimet ndërtimore sipas lejes ndërtimore në objektet për banime kolektive, me afarizëm, etj.	50 €	0€
23	Pëlqim rreth plotësimit të kushteve minimale teknike të bizneseve individuale dhe shoqërive tregtare	30€ për organizata biznesesh, 20 € për biznese individuale	15 €
24	Vendosja e objekteve të përkohshme apo objekteve tjera montuese (lëvizëse) për zhvillim të veprimtarisë tregtare (pagesë mujore), për metër katror	0.25 € - Tezga, aparate për pomfrit, për palagaçe 0.50 € - Aparate për akullore 0.30 € - Auto- dyqane lëvizëse	Zona I: 0.40 € Zona II: 0.20 € Zona III. 0.05 € Objekte mbi 10m2: Zona I: 1 € Zona II: 0.60 € Zona III. 0.30 €
25	Vendosja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike (për metër katror)	0.25 € për metër katror	Zona I: 0.20 € Zona II: 0.10 € Zona III. 0.05 €
26	Vendosja e objekteve të përkohshme apo objekteve tjera montuese rekreative si kamp-shtëpiza, lojëra për fëmijë, etj., për metër katror -	0.13 € për metër katror (ditore)	Zona I: 0.20 € Zona II: 0.10 € Zona III. 0.05 €
27	Vendosja e objekteve të përkohshme – Baraka dhe Garazh (për metër katror)	26 € në muaj	Zona I: 4 € Zona II: 3 € Zona III. 1 €
28	Vendosja e objekteve të përkohshme – Kioska (për metër katror)	26 € në muaj	Zona I: 6.5 € Zona II: 4 € Zona III. 1.5 €
29	Certifikatë mbi gjendjen ekonomike	2 €	0 €
30	Vërtetim për vizë për të gjitha shtetet	2 €	0 €
31	Vërtetim për lirim nga shtetësia e Kosovës	20 €	0 €
32	Vërtetim për pranimin e shtetësisë së Kosovës	10€	0 €


33	Vërtetim që personi nuk është nën kujdestari	10€	0 €
34	Vërtetim që personi nuk merr asistencë sociale	3€	0 €
35	Vërtetim për bashkimin familjar	20€	0 €
36	Vërtetim për mbajtje të armës	20€	0 €
37	Kërkesë për regjistrim të mëvonshëm të fëmijëve	5€	0 €
Shërbimet e eliminuara			
38	Certifikata që personi është i ve	1€	0€
39	Certifikata për raportin farefisnor	1€	0€
40	Certifikata që personi është i vetëm	1€	0€
41	Certifikata për vendbanim të përkohshëm	1€	0€
42	Certifikata për varësi materiale	1€	0€
43	Certifikata që personi ka jetuar në bashkësi familjare deri në vdekjen e bashkëshortit	1€	0€
44	Vërtetim për gjendjen e statusit	1€	0€
45	Certifikata që personi nuk është në marrëdhënie pune	1€	0€
46	Certifikata që personi është nën mbikëqyrjen e anëtarit të familjes	1€	0€
47	Legalizimi i nënshkrimit autentik (vërtetimi i nënshkrimit)	2.50 €	0€
48	Vërtetimi i fotokopjes (A4)	0.25 €	0€
49	Vërtetimi i fotokopjes (A3)	0.50 €	0€
50	Kurorëzimet jashtë objektit të administratës gjatë orarit të punës	50€	0€
51	Kurorëzimet jashtë orarit të punës në vende publike	100 €	0€
52	Certifikata sipas kërkesës së palës së Komunës e Prizrenit nuk është e interesuar	5 €	0€

53	Aktvendim për të drejtën e përparësisë së ndërtimit	15 €	0€
54	Aktvendim për uzurpimin arbitrar të tokës në pronësi shoqërore	25 €	0 €
55	Inspektim brenda dhe jashtë qytetit	10 €	0€
56	Pëlqim për kycje në rrugë	40 €	0 €
57	Taksa për bllokim të rrugës për persona juridik dhe për persona fizik	100€/40 € (ditore)	0 €
58	Shfrytëzimi i hapësirës publike në nëntokë me kablo	0.05 €/m' (vjetore)	0 €
59	Pëlqim për vendosje të antenave telekomunikuese, për një antenë në hapësirë publike dhe private	2000 € (vjetore)	0 €
60	Certifikata e përdorimit për objekte individuale	100 €	0 €
61	Certifikata e përdorimit për objekte kolektive	1000 €	0 €
62	Taksat për ushtrimin e veprimtarisë afariste për të gjitha kategoritë e bizneseve	T arifa të ndryshme në bazë të kategorive të biznesit (Neni 43 i rregullores së vitit 2019) 0€	0€

SHTOJCA 4: LISTA E SHËRBIMEVE TË THJESHTUARA NË KOMUNËN E FERIZAJT

Dëshmitë mbi thjeshtimin e shërbimeve të Komunës së Ferizajt, të inventarizuara më poshtë, gjenden në Rregullore 02/2022 për taksat komunale, miratuar nga Kuvendi Komunal me datë 30 nëntor 2022, e publikuar me 6 mars 2023.

Duhet të theksojmë se thjeshtimi i këtyre shërbimeve nuk është kufizuar vetëm në pagesat administrative, por edhe në dokumente, kërkesa, vlefshmëri, etj., të cilat nuk janë të paraqitura në tabelën së mëposhtme.



Komuna e Ferizajt			
Nr	Shërbimi	Pagesa administrative	
		Para thjeshtimit	Pas thjeshtimit (2022)
1	Certifikatë e statusit martesor	3€	1 €
2	Certifikatë vendbanimi	2 €	1 €
3	Certifikatë për lajmërim apo ç 'lajmërim të vendbanimit	2.5 €	1 €
4	Akti i vdekjes	5 €	2 €
5	Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes në institucionet shëndetësore brenda territorit të Kosovës	50€	20 €
6	Regjistrimet e mëvonshme të vdekjeve kur nuk është regjistruar lindja dhe vdekja	50 €	50€
7	Korrigjimi i emrit personal	5€	2€
8	Korrigjimi dhe plotësimi në dokumentet e arkivuara	5 €	2 €
9	Licence / leje auto-taksi (taksi individual 5 vite)	20 €	50€
10	Leje per operator taksi (5 vite)	150 €	250 €
11	Leje për kryerjen e transportit rrugor të mallrave deri 12 ton (5 vite)	100 €	50€
12	Vërtetimi, vazhdimi i rendeve të udhëtimit në transportin publik të udhëtarëve urban dhe urban periferik	0 €	0.5€/km + 5 euro aplikimi (pagesë për tri vite)
13	Leje për ndalje të përkohshme në rrugë për ngarkim shkarkim të mallrave të ndryshme	10 € / orë	10€ / muaj (pagesë mujore)
14	Leje e përkohshme për hyrje në shesh/qytet me mjete motorike	Pagesa të ndryshme varësisht llojit të automjete (tani këto leje janë bashkuar)	Pagesë ditore: 5 € Pagese vjetore: 150 €
15	Pëlqim/certifikatë për kryerjen e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave për minibus dhe autobus	Minibus: 15 euro Autobus: 25 euro	25 €
16	Pëlqim/certifikatë për kryerjen e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave për automjete transportuese të mallrave deri në 12 ton	25 €	15 €
17	Regjistrimi i automjeteve mbi 3.5 ton	25 €	20 €
18	Gërmim/dëmtim të rrugëve me asfalt	20 €/m'	Për të gjitha llojet e dëmtimeve: 50 euro / m2 për persona fizik; 80 euro/m2 për persona juridik
19	Gërmim/dëmtim të rrugëve me kube dhe kthimi në gjendje të mëparshme	10 €/m'	
20	Gërmim/dëmtim të sipërfaqeve të gjelbra, me zhavorr, dhe sipërfaqe të tjera të papërpunuara dhe kthimi në gjendje të mëparshme	0 €/m'	
21	Shfrytëzimi i hapësirës publike me orman dhe pajisje tjera për energjetikë dhe telekomunikim (tarife vjetore)	10 € / m2 (tarifë vjetore)	Figuron si 'leje për shfrytëzim të hapësirës publike për punë ndërtimore – 20 EUR taksa për qytet, 5 EUR jashtë qytetit (për m2)
22	Kërkesë për kontroll inspektues në qytet dhe jashtë qytetit nga persona fizikë dhe juridik	10€	0

23	Pëlqim rreth plotësimit të kushteve minimale teknike dhe higjienike per bizneseve individuale dhe shoqëri tregtare	25 € për subjekte afariste (kioska, tenda, taksi)	15 €
		50 € për objekte individuale banimi, objekte afariste, dhe subjekte tjera afariste	
		100 € (pëlqim sanitar) – objekte industriale (është praktikuar 50 €)	
		200 € (pëlqim sanitar) – objekte per prodhim te kimikateve (është praktikuar 50 €)	
24	Kërkesë për asgjësim mallrash	15 €	20 €
25	Pëlqime të ndryshme nga sektori i ndërtimitarisë	10 €	10 €
26	Vendosja e objekteve të përkohshme apo objekteve tjera montuese (lëvizëse) për zhvillim të veprimtarisë tregtare (pagesë mujore), për metër katror (m2)	Objekte deri 10m2: Zona I: 4€ Zona II: 2€ Zona III: 1€ Objekte mbi 10m2: Zona I: 4€ Zona II: 1.5€ Zona III. 1€	<ul style="list-style-type: none"> Aparate për patate, gështenja, misër, etj.: Zona 1: 5€; Zona 2: 3€; Zona 3: 2€; Zona A: Zona B: 0.50€ Aparate akulllore: 1€; për Zona 1: 7€; Zona 2: 5€; Zona 3: 3€; Zona A: 1.5€; Zona B: 0.75€
27	Vendosja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike për metër katror (m2)	Zona I: 3€ Zona II: 2€ Zona III. 2€	Taksa ditore (m2): 5€ (qendër), 2€ (jashtë qendrës), 1.5€ (zona rurale)Taksa javore (m2): 10€ (qendër), 7€ (jashtë qendrës), 3€ (zona rurale)
28	Vendosja e gjeneratorëve në hapësira publike për metër katror	Zona I: 50€ Zona II: 20€ Zona III. 10€	Zona 1: 20€; Zona 2: 15€; Zona 3: 10€; Zona A: 7€; Zona B: 4€
29	Vendosja e objekteve të përkohshme apo objekteve tjera montuese rekreative si kamp-shtëpiza, lojëra për fëmijë, etj., për metër katror	Zona I: 10€ Zona II: 8€ Zona III. 5€	Lojëra për fëmijë: Zona 1: 4€; Zona 2: 2€; Zona 3: 1€; Zona A: 0.50€; Zona B: 0.25€
30	Vendosja e objekteve të përkohshme – Baraka dhe Garazha (për metër katror)	Zona I: 4€ Zona II: 3€ Zona III. 1€	Objekte të mbuluara: Zona 1: 15€; Zona 2: 10€; Zona 3: 5€; Zona A: 3€; Zona B: 1.5€
31	Vendosja e objekteve të përkohshme – Kioska (për metër katror)	Zona I: 7€ Zona II: 6€ Zona III. 5€	Objekte të mbuluara: Zona 1: 15€; Zona 2: 10€; Zona 3: 5€; Zona A: 3€; Zona B: 1.5€
32	Vendosja e objekteve të përkohshme apo objekteve tjera, baner, city light, bilbordet, ekranet reklamuese, si dhe forma tjera te reklamimit etj., në hapësira publike, (për metër katror)	Zona I: 3€ Zona II: 2.5€ Zona III. 2€	Banera (Taksa ditore): Zona 1: 10€; Zona 2: 8€; Zona 3: 5€; Zona A: 2.5€; Zona B: 1.25€ Banera (Taksa javore): Zona 1: 20€; Zona 2: 15€; Zona 3: 10€; Zona A: 5€; Zona B: 2.5€ Banera (Taksa mujore) Zona 1: 30€; Zona 2: 20€; Zona 3: 15€; Zona A: 7.5€; Zona B: 5€ Llamposa (Taksa për copë) Zona 1: 20€; Zona 2: 15€; Zona 3: 10€; Zona A: 5€; Zona B: 5€
33	Vërtetim për lirim nga shtetësia e Kosovës	0 €	50€
34	Vërtetim për pranimin e shtetësisë së Kosovës	0 €	5€
35	Vërtetim që personi nuk është nën kujdestari (për punësim)	0 €	Nuk figuron në rregullore por është praktikuar tarifa prej 5 €

36	Vërtetim që personi nuk merr asistencë sociale	0 €	3 €
37	Vërtetim për bashkim familjar, është praktikuar si vërtetim që personi është vetëm	0 €	Nuk figuron në rregullore por është praktikuar tarifa prej 5 €
38	Vërtetim për mbajtje të armës / që nuk i është hequr zotësia e veprimit	0€	Në rregullore nuk figuron si 'Vërtetim për mbajtje të armës' por 'Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e veprimit' - 5 €
39	Kërkesë për regjistrim të mëvonshëm të fëmijëve	0€	5€
40	Kërkesa për leje urbane	5€	0€
41	Kërkesa për leje ndërtimi	10€	0€
42	Kërkesa për leje rrërimi	5€	0€
43	Kërkesa për leje përdorimi	10€	0€
44	Kërkesa për leje mjedisore komunale	10€	0€
45	Kërkesa për leje copëtimi	5€	0€
46	Kërkesa për ekstrakt nga plani urban	10€	0€
47	Kërkesa për njoftim/vërtetim/ankese	10€	0€
48	Kërkesa për dublikatë	10€	0€
49	Kërkesa për legalizim	0€	0€
Shërbimet e eliminuara			
50	Vërtetim identiteti	10€	0€
51	Vërtetim për leje qëndrim	1€	0€
52	Legalizimi i kopjeve në bazë të origjinalit (A4)	1€	0€
53	Legalizimi i kopjeve në bazë të origjinalit (A3)	2€	0€
54	Pajisja me dokumente nga arkiva deri në pesë kopje	2€	0 €
55	Pajisja me dokumente nga arkiva më shumë se pesë kopje	3€	0€

56	Vërtetim për shtesa të fëmijëve	5€	0 €
57	Certifikata mbi gjendjen ekonomike	5€	0 €
58	Procesverbali për pranimin e atësisë dhe amësisë	1€	0 €
59	Vendosja e ngadalësuesve të shpejtësisë në rrugë për qetësimin e komunikacionit	10 €	0 €
60	Leje e përkohshme për hyrje në shesh/qytet me mjete transportuese të mallrave komerciale mbi 3.5 ton	Ditore 5 €, javore 10 €, mujore 25 €, vjetore 150 €	Janë shkrirë në 'Leje për hyrje në qytet me mjete motorike' – taksa ditore: 5 €, taksa vjetore: 150 €
61	Leje e përkohshme për hyrje në shesh/qytet me mjete automjet transportues të udhëtarëve	(ditore 5, mujore 10, vjetore 100 euro)	
62	Leje e përkohshme për hyrje në shesh/qytet me kamion transportues për largimin apo sjelljen e materieve të ngurta (5 euro)	5 €	
63	Kërkesa për ekshumimin (zhvarrosjen e një personi)	100 €	0 €
64	Kërkesë për zgjatje të orarit të punës për objekte hoteliere	50€	0€
65	Pëlqim sanitar për objekt individual banimi	50€	Janë shkrirë në 'Pëlqim rreth plotësimin të kushteve minimale teknike dhe higjienike (sanitare) të bizneseve individuale dhe shoqërive tregtare' që kushton 15 €
66	Pëlqim sanitar për objekte afariste	50€	
67	Pëlqim sanitar për objekte industriale	100 € (në praktike është praktikuar tarifa 50 €)	
68	Pëlqim sanitar për subjekte specifike për prodhimin e kimikateve dhe substancave të rrezikshme për ambientin	200 € (në praktike është praktikuar tarifa 50 €)	
69	Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosje të bankomateve, foltoreve telefonike, ormanëve, antenave	Tarifa të ndryshme sipas zonave	0€
70	Shfrytëzimi i hapësirës publike për punë ndërtimore	Taksa mujore për 1m2: 20 € për qytet, 5 € jashtë qytetit	Është shkrirë në "Lejen e ndërtimit"
71	Leje e përdorimit të objekteve	20 € për objekte të banimit individual; 300 euro për banim kolektiv	banimit individual; 300 euro për banim kolektiv Është shkrirë në "Lejen e ndërtimit"
72	Pëlqim për martesë para moshës madhore	10€	0€
73	Pëlqim për bartjen e pasurisë	3€	0€
74	Pëlqim për dokument udhëtimi	3€	0€
75	Kërkesa për përfaqësim në gjykatë të fëmijës lidhur me trashëgiminë dhe kontrata të ndryshme	5€	0€


SHTOJCA 5: LISTA E SHËRBIMEVE TË THJESHTUARA NË KOMUNËN E PEJËS

Dëshmitë mbi thjeshtimin e shërbimeve të Komunës së Pejës, të inventarizuara më poshtë, gjenden në Rregullore Komunale 02/2023 (KPE) për taksat komunale, miratuar nga Kuvendi Komunal në korrik 2023, e publikuar me 31 tetor 2023 dhe hyrë në fuqi me 1 janar 2024.

Duhet të theksojmë se thjeshtimi i këtyre shërbimeve nuk është kufizuar vetëm në pagesat administrative, por edhe në dokumente, kërkesa, vlefshmëri, etj., të cilat nuk janë të paraqitura në tabelën së mëposhtme.

Komuna e Pejës			
Nr	Shërbimi	Pagesa administrative	
		Para thjeshtimit	Pas thjeshtimit
1	Kërkesa, parashtrësia, propozime, etj.	1€	0€
2	Shërbimet jashtë selisë së organit për shërbime tëveçanta	10 €	0 €
3	Lidhja e kurorës jashtë objektit me shtetas të huaj	100 €	70 €
4	Licencë/Leje auto-taksi	250 €	50 €
5	Leje për operator taksi	50 €	50 €
6	Licencë/Leje për transport urban dhe urban-periferik	300 €	150 €
7	Licenca për pije alkoolike (vjetore)	Hotel Zona1-500 € Zona2-350 € Zona3-300 € Zona4-200 € Restorant Zona1-250 € Zona2-200 € Zona3-180 € Zona4-150 € Kafeteritë Zona1-120 € Zona2-100 € Zona3-80 € Zona4-80 € Diskotekat- Baret Zona1-1000 € Zona2-900 € Zona3-800 € Zona4-700 €	Hotel Zona1-250 € Zona2-175 € Zona3-150 € Zona4-100 € Restorant Zona1-200 € Zona2-150 € Zona3-50 € Zona4-50 € Kafeteritë Zona1-100 € Zona2-100 € Zona3-50 € Zona4-50 € Diskotekat- Baret Zona-NUK LEJOHET Zona2-NUK LEJOJET Zona3-NUK LEJOHET Zona4-NUK LEJOHET
8	Lejet për zgjatjen e orarit të punës	Hotel Zona1-1500 € Zona2-1000 € Zona3-800 € Zona4-700 € Restorant Zona1-1000 € Zona2-800 € Zona3-700 € Zona4-700 € Kafeteritë Zona1-200 € Zona2-150 € Zona3-100 € Zona4-50 € Diskotekat- Baret Zona1-2000 € Zona2-1500 € Zona3-1200 € Zona4-1000	Hotel Zona1-750 € Zona2-500 € Zona3-400 € Zona4-350 € Restorant Zona1-500 € Zona2-400 € Zona3-350 € Zona4-350 € Kafeteritë Zona1-200 € Zona2-150 € Zona3-100 € Zona4-50 € Diskotekat- Bar- et Zona1-Nuk lejohet Zona2-Nuk lejohet Zona3-1000 € Zona4-1000 €
9	Leja për prerjen e asfaltit në rrugë dhe trotuare për 1 m2 - personi fizik dhe personi juridik	Fizik – 50 € Juridik – 200 €	40 €
10	Leja për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të pa kategorizuara (me zhavorr) m2.	10 €	5 €
11	Vendosja e shtandeve të hapura dhe lëvizëse 11 për promovimin, reklamimin apo çfarëdo aktiviteti afarist-tarifa ditore në m2	Zona1- 4 € Zona2- 2 € Zona3- 1 €	Zona1- 3 € Zona2- 2 € Zona3- 1 €
12	Leje për damkimin e trungjeve të klasifikuar me dru teknik	5 € m2	3€ m2

13	Leje për damkimin e trungjeve të klasifikuar si dru zjarri	3 € m2	1,5 m2
14	Certifikatë që merret me veprimtari bujqësore	2€	0€
15	Pëlqim për plotësimin e kushteve minimale teknike të lokaleve afariste	Të ndryshme	Janë disa lirime për kategoritë të ndryshme të bizneseve
16	Kërkesë për kontroll inspektues	70€	0€
Shërbimet e eliminuara			
17	Deklarata për dy dëshmitarë	1€	0 €
18	Vërtetimi për lajmërimin dhe ç'lajmërimin e vendbanimit për bashkatdhetarët	3€	0€
19	Vendosja e bus ndaljeve (stac. Pritëse për udhëtar) m2	2€	0€
20	Leja për vendosjen e materialit ndërtimor në hapësira publike për 1 m2 (tarifa 1muajore)	1.5 €	0€
21	Pëlqimi për zhvendosjen (eskumacionin e kufomave) të mbeturat nga kufoma	10 €	0€
22	Certifikatë për shitjen e prodhimeve bujqësore jashtë vendit	5€	0€
23	Pëlqimet për shfrytëzimin e: Shkëmbinjve të fortë, Deluvion dhe Proluvion	100 €	0€
24	Vërtetim për të dëshmuar pronësinë e mekanizmit bujqësor	2€	0€
25	Vërtetim për posedim të parkingut (automjeteve transportuese)	50€	0€
26	Vërtetim për lejim të shfrytëzimit të rrugëve me peshë të rëndë se sa lejohet	500 €	0€
27	Vërtetim për lejimin e distribuimit të mallit	50€	0€
28	Mos pastrimi i hapësirave me borë dhe akull para objekteve të banimit në trotuar për persona fizik dhe juridik	Fizik-20€ Juridik - 50 €	0€
29	Pëlqim për Bartje të Pasurisë	0€	0€



**Periudha e
raportimit:
2022-2023**

Janar 2024
